



HISTORIA



**72 VJET MË
PARË - SI U
KRIJUA MINIERA
E BULQIZËS**
HALIL RAMA

Faqe 6-7

ANALIZË



**TRAGJEDI NË
FAMILJEN TOLA NË
OSTREN. HUMBIN
JETËN NËNA ME DY
FËMIJË**

Faqe 4

HOMAZH



**MUSA LALA,
IKJA PA
KTHIM
E NJË IKONE**
NGA DEFRIM METHASANI

Faqe 9

Presidenti Meta vlerësoi solidaritetin në këtë aktivitet të Bashkësisë Dibrane dhe artistëve të Teatrit Kombëtar

"TIRANA, 100 VJET KRYEQYTET", ME SHTATË KRYEBASHKIAKË DIBRANË

Kongresi i Lushnjës dhe Dibra

PROF. DR. BAJRAM XHAFA

Kur flasim për Kongresin e Lushnjës (janar 1920) kemi parasysh ngritjen e shtetit të parë shqiptar, shtetit kombëtar. Kjo e bën rëndësinë e kësaj ngjarjeje të pakrahasueshme me simotrat e saj dhe e klasifikon atë si më të madhen në historinë e shqiptarëve. Që këtej, pyetja sugjestionuese: Kush e bëri atë Kongres? Përgjigja edhe më sugjestionuese dhe paksa provokuese: Nis-sos Kongresi i Lushnjës ka qenë vepër e Zogut, vepër e përkryer e Ahmet Zogut, e kurrkujt tjetër. "Zogu që shtylla ushtarake e politike e Kongresit të Lushnjës (nënvizimi B Xh) shkruan Mihtar Spahija...Klika, një grup terrorist dashti me e zhdukë me plum...". "Ky njeri i habitshëm kishte lemë me sunue..." Edhe sundoi deri më 1939-n.

Karakter: Kongresi i Lushnjës ishte një kongres mirëfilli kombëtar dhe "shteti i dalë nga Lushnja ishte një shtet mirëfilli kombëtar, ndryshe nga krijesa e Fuqive të Mëdha në vitet 1912-1914", shkruan prof. Arben Puto. Në Lushnje Shteti Shqiptar u ngrit, nuk u ringrit. "Pa Lushnjën nuk do të kishte ndodhë mrekullia e Vlorës... . Janë të lidhura në mënyrë kauzale. Edhe kjo ishte vepër e Zogut. Ekskluzivisht. S. Delvina ishte "kryeministër nominal", ndërsa në krye ishte Zogu", shkruan Mustafa Kruja.

Pyetje: Po "shoq", mik apo aleat kush iu bë Shqipërisë? Kush e kurdisi zemrekun e sahatit? Përgjigje: Britania e Madhe. Misionarët e saj: Konsulli Eden i Intelgjenc Services, që i ranë kambët duke i rënë rrotull Shqipërisë.

Faqe 2



Prof.Dr. Bujar Kapexhiu - "Nderi i Kombit":

- Nga komuniteti ynë dibran kanë dalë disa kryetarë bashkie dhe prefektë, duke filluar nga personalitete si Qamil Pepa, Rexhep Jella, Izet Shatku, Ali Erebara, Edlira Haxhiymeri, Jashar Mezenxhiu dhe i fundit dibran Lulzim Basha.
- Dibranët e Tiranës, mbi 107 vjet në Tiranë, nuk e kanë harruar kurrë mikëpritjen bujare dhe bamirëse të tiranasve, e cila shkon më tej duke shkëmbyer dhe lidhje familjare me njëri-tjetrin.



FJALA

Faqe 2

Dibranët përgjenden me besim dhe dashuri ndaj komunitetit tiranas

PROF.DR.BUJAR KAPEXHIU – NDERI I KOMBIT

SOCIALE

Faqe 8

Sitali i Bulqizës, masa për coronavirusin



IN MEMORIAM

Faqe 5

**Homazh për
biznesmenin
Murat Duriçi**



7-8 MARS

Faqe 10

**Një gjyshe
e lumtur**

NGA ZABIT LLESHI



DEDIKIM

Faqe 11

Letër babait

NGA

DHURATA KOLA KALOSHI



Dibranët e Tiranës, mbi 107 vjet në Tiranë, nuk e kanë harruar kurrë mikëpritjen bujare dhe bamirëse të tiranasve

Dibranët përulen me besim dhe dashuri ndaj komunitetit tiranas

PROF.DR.BUJAR KAPEXHIU – NDERI I KOMBIT

• *Me një eksod masiv, popullsia e Dibrës së Madhe, më 20 shtator të vitit 1913, do të dëbohej nga genocidi serb. E prej kësaj treve, duke ecur ditë dhe natë më këmbë, ata arritën gjer në Tiranë. Pikërisht prej këtij rrugëtimi të mundimshëm, nga këta njerëz të dëbuar, ne i quajmë: muhaxhirët dibranë. Do të ishte kryetari i parë i Tiranës, Zyber Hallulli, i cili së bashku me parinë tiranase do të dilte në Shkallën e Tujanit, me lot në sy, me bukë, ujë dhe zemër, të priste dibranët e sflitur nga genocidi sllav.*

Është kjo forcë e veçantë e mikëpritjes që karakterizon Tiranën tonë, e cila na pranoi, por dhe na vlerësoi.

Paraardhësit tanë, tiranas e dibranë, para 100 vjetësh u mbledhën së bashku për të festuar Tiranën kryeqytet.

Pra, 100 vjet nga ajo ditë e shënuar që ky truall u quajt kryeqyteti i Shqipërisë. Sa punë, sa mund, sakrificë e përpjekje, sa figura të shquara tiranase e dibrane janë skalitur në historikun e këtij kryeqyteti në këta 100 vjet. Dhe ne sot mbas 100 vjetësh, përsëri jem së bashku, në këtë sallë (të Teatrit Kombëtar) me vlera historike, artistike e kulturore, për të përkujtuar besën e të parëve tanë, bashkëpunimin, miqësinë e patriotizmin e tyre. Duke nderuar të parët, në radhë të parë nderon veten dhe unë vetë ndiej krenari, ashtu si të gjithë ju, për ata që menduan, punuan e dhanë me pasion e ndershmëri gjithçka që kishin të shtrenjtë e të shenjtë, për dinjitetin dhe prosperitetin e kryeqytetit të tyre. Dhe ja ku jemi sot. Kemi ç'të kujtojmë. Kemi shumë. Jam i sigurt që një event i tillë është i pamjaftueshëm për të përmbledhur e paraqitur madhështinë e këtyre figurave të paharruara. Prandaj ky vit është caktuar viti i Tiranës, viti i 100 vjetorit të kryeqytetit.

Me një eksod masiv, popullsia e Dibrës së Madhe, më 20 shtator të vitit 1913, do të dëbohej nga genocidi serb. E prej kësaj treve, duke ecur ditë dhe natë më këmbë, ata arritën gjer në Tiranë. Pikërisht prej këtij rrugëtimi të mundimshëm, nga këta njerëz të dëbuar, ne i quajmë: muhaxhirët dibranë.

Do të ishte kryetari i parë i Tiranës, Zyber Hallulli, i cili së bashku me parinë tiranase do të dilte në Shkallën e Tujanit, me lot në sy, me bukë, ujë dhe zemër, të priste dibranët e sflitur nga genocidi sllav. Është kjo forcë e veçantë e mikëpritjes që karakterizon Tiranën tonë, e cila na pranoi, por dhe na vlerësoi.

Nga komuniteti ynë dibran kanë dalë disa kryetarë bashkie dhe prefektë, duke filluar nga personalitete si Qamil Pepa, Rexhep Jella, Izet Shatku, Ali Erebara, Edlira Haxhiymeri, Jashar Mezenxhiu dhe i fundit dibran Lulzim Basha.

Dibranët e Tiranës, mbi 107 vjet në Tiranë, nuk e kanë harruar kurrë mikëpritjen bujare dhe bamirëse të tiranasve, e cila shkon më tej duke shkëmbyer dhe lidhje familjare me njëri-tjetrin.

Ashtu siç e kemi të shprehur në Kushtetutë harmoninë fetare, si pjesë e panteonit të vlerave universale që karakterizojnë kombin tonë, ne dibranët sot përulemi me besim dhe dashuri ndaj komunitetit tiranas, i cili na hapi



dyert jo vetëm një herë por disa herë; jo vetëm për ne të komunitetit dibran të Ti-

ranës, por edhe gjatë eksodit çam, tokë më në fund edhe atij geg.

Me rastin e 100 vjetorit

Kongresi i Lushnjës dhe Dibra

Prof. dr. Bajram XHAFI

• *Delegatët e Dibrës në kongres kanë qenë: Ramiz Daci, ndërsa nga paria nacionaliste ishin Dine Dema e Dine Maqellara (Nasufi).*

(vijon nga fq.1)

Gjenerali Filipi, ish komandant i trupave aleate në Shkodër më 1913-14 dhe vjen si aleat në Shkodër më 1919.

Vetëm ky mund t'i ujdite punët në Shkodër. "Luani britanik" është edhe i frikshëm. Ishte dhe një tjetër: Josef Haven, delegat (nga Presidenti Wilson) për të bërë hetimet e nevojshme në Shqipëri. Austro-Hungaria nuk ishte më në sofrën politike, kishte vdekë. Këta misionarë i "këshillojnë" shqiptarët të bënin një kongres, të ngrinin një qeveri kombëtare, të rrezonin qeverinë proitaliane të Durrësit dhe të çlironin Vlorën. Të tjerat pastaj i bënin vetë. Në Lushnjë fryma e mbledhjes ishte katërcipërisht lundëritale, shkruan Eqrem bej Vlora, një floitalian e proteksionis i thekur. Ishte një kongres kryengritës. Pa Kongresin e Lushnjës, "Pavarësia do të kishte qenë një akt iluzor, i paqendrueshëm", ashtu siç, pa Lushnjën nuk do të kishte pasur as Mbretëri Shqiptare, as shtet shqiptar. Edhe Lushnjën (Kongresin), edhe shtetin, edhe Mbretërinë i bëri Zogu, Ahmet bej Zogu.

Nëse rrëzoheshin kërkesat italiane për Vlorën dhe protektoratin italian mbi Shqipërinë, binin poshtë edhe pretendimet e fqinjëve të tjerë, të Jugosllavisë dhe Greqisë. Prandaj ky është quajtur edhe Kongresi i Shpëtimit.

Më 1920 shqiptarët ndodheshin para detyrës së vendosjes së pavarësisë (më 1912 ajo vetën se qe shpallur) dhe sigurimi i tërësisë tokësore brenda kufijve të 1913-s. Këtë detyrë e mori përsipër Kongresi i Lushnjës në janar 1920 dhe e zgjidhi Lëvizja Çlirimtare e shqiptarëve, hallka të së cilës ishin Lufta e Vlorës, Lufta e Dibrës dhe ajo e Koplikut, të vitit 1920, të cilat ishin shprehje e zbatimit të vendimeve të Kongresit të Lushnjës. Të gjitha lidhen me një emër: Ahmet Zogu.

Pyetje: Vendi i Dibrës në Kongresin e Lushnjës.

Kur përmendim Dibrën na vijnë në mendje dy përcaktime në trajtë deduksioni:

1. Më 1908 konsulli i Austrisë në Manastir August Kral i shkruante Vienës: "Sytë e gjithë shqiptarëve janë drejtuar nga Dibra, dhe në të vërtetë këtu gjendet pika e gravitetit të situatës së Shqipërisë".

2. Statisti i shquar Ferit Pashë Vlora, ish - kryeministër i Perandorisë Osmane (1903-1908) shkruan: "Në dy Dibrat është zemra e Shqipërisë, Porta e vërtetë e Shqipërisë është atje, Kurdoherë".

Delegatët e Dibrës në kongres kanë qenë: Ramiz Daci, ndërsa nga paria nacionaliste ishin Dine Dema e Dine Maqel-

lara (Nasufi). Dibranët iu bashkuan me zjarr e me shpirt idealit të "Lushnjës". Por edhe me forca. Pushkën e mbanin në krahë. Nga qytetaria e Dibrës: Ramiz Bej Dibra i Iliaz Pashës, (kështu e quan vazhdimisht I. Strazimiri në "Kujtimet..." e tij), bejlerët e Maqellarës, Dine Bej Maqellara, Izet Bej Maqellara, Fiqiri Dine; Ramiz Daci, Jashar Erebara, Ismail Strazimiri (Dibër), sheherlinjtë e Dibrës së Madhe grumbulluar në Tiranë, Elbasan e Peshkopi: Myftiu i Dibrës Vehbi Dibra (Agolli) e Hafiz Sherif Langu, Abdurrahman Dibra e Shefki Shatku, Izet Dibra (Shatku) e Faik Shatku, vëllezërit Selim e Riza Rusi, Zenepe Çoku (e shoqja e Dervish Himës) e Aziz Menzelxhiu, Hasan Ballanca e Sheh Latifi, e patriotë të tjerë dibranë: Kadri Fishta e Eqrem Cami, Ibrahim Xhidri e Abdullah Tërshana, Ibrahim Jegeni e shehlerët e Peshkopisë, etj. etj.

Përveç vokacionit kombëtar, me platformën e Lushnjës sheherlinjtë e Dibrës i lidhte edhe një miqësi familjare me Zogun që në fillimet e shekullit XX kur Xhemal Pasha shërbente në Dibër të Madhe (alias Sheheri i Dibrës) si funksionar i Perandorisë Osmane. Miqtë e vjetër të babës u bënë edhe për të birin. Shkukur e shpërgulur me dhunë ushtarake prej trollit të tyre shumëshekullor nga soldateska serbe dhe, shumica grumbulluar në Tiranë, në "Rrugën e Dibrës", dibranët përbënin ajkën e qytetarisë së kryeqytetit.

Lidhur fort pas atdheut dhe besimit, ata u bënë bashkidealistë e bashkluftëtarë të çështjes kombëtare dhe të projektit të Zogut në sendërtuarimin e platformës së Lushnjës. Njëherazi ata ishin burra të kultivuar bukur mirë dhe esnafë në punët e qeverisë e të njerëzisë. Nuk është e rastit që ata më vonë u ngritën në detyra të larta e me përgjegjësi në administratën e Shtetit të parë Shqiptar. Nga Sheherlinjtë e Dibrës ka protagonistë të shumtë si administratorë të zotë e burra shteti. Ata u bënë shtylla të shtetndërtimit dhe të kombformimit shqiptar. Një përcaktim të saktë dhe me kompetencë për këtë fenomen na e japin dy personalitete në kohë të ndryshme: Terenc Toçi i viteve '20 kur për Zogun thotë se, ishte ai që i bëri fiset komb dhe kombin shtet. I dyti është historiani amerikan Bernd Fischer: "Pavarësisht se ç'farë mendojnë për Mbretin Zog, ai qartazi ishte një figurë vendimtare në zhvillimet (ngritjen) e shtetit dhe kombit shqiptar". Në këtë proces historik dibranët kanë rol të dorës së parë në të gjitha drejtimet, politik, ushtarak, shoqëror e kulturor. Kjo fillon me Kongresin e Lushnjës. Me të drejtë dy presidentët e fundit (Nishani dhe Meta) disave prej tyre u kanë akorduar titullin më të lartë "Nderi i Kombit". Duhet përgëzuar këtu edhe puna e kujdesshme e Shoqatës "Bashkimi Dibran" me drejtues prof. Bujar Kapexhiu dhe Saimir Shatku. Peng i shoqatës duhet të mbesë vlerësimi i Ab-

Tradita e miqësisë, bashkëpunimit, bashkëjetesës midis qytetarëve autoktonë tiranas dhe qytetarëve dibranë të ardhur vite më parë, i kalon të 100 vjetët, por sot të dy komunitetët së bashku festojnë 100 vjet si kryeqytetas.

Sot nuk më duket e tepërt, por e saktë, ne të gjithëve tiranas e dibranë na lejohet që gjatë këtij viti, kur dikush të na pyesë nga jeni zotëri, me mburrje, ose siç thonë tironsit me tangërlilik, të themi: jemi kryeqytetas!

Shoqata "Bashkësia Dibrane" e ndien për detyrë morale, që ashtu siç t'i përulemi Perëndisë, t'i përulemi me respekt dhe emocion komunitetit të nderuar tiranas. Faleminderit e ju jemi përjetë mirënjohës!



durrahman Dibrës dhe sidomos i të birit të tij, Qenanit, të cilin diktatura e pushkatoi në lulen e rinisë si monarkist i bindur dhe i ndërgjegjshëm. Qenan Dibra është nacionalist e antikomunisti më i panjollë.

Nga pjesa e krahut të armatosur të lëvizjes së shtetndërtimit dhe kombformimit në Dibër kanë qenë sidomos shtresa e mesme, agallarët si: Demet e Homeshit, Dine e Shaqir Dema, Selim Dema etj; nga dera e Selman Alisë, pasardhës të Salë Demirit, Dine Hoxha e Ali Tahiri (Pira)-Muhurr, Maliq Kërçisht (Agolli), Dan Cami (i Sepetovës) dhe Camet e Viçishtit, Kaloshet e Sinës e të Kandrit, Ndrëtë e Elezit Isufit e Suf Xhelili në Sllovë, Riza e Dervish Lusha (Arras), Murat Kaloshi e Selim Noka (Kandër), Haxhi Noka (Grykë Nokë), Sali e Selim Kaloshi (Sinë), Selman e Hakik Mena (bajraktari i Lurës), Selë Bajraktari (Arras) e Lita i Ploshtanit, Shehu i Zerqanit e Duriçi i Bulqizës, Kazihani i Selishtës (Tafa) e Llan Destani - Ndrejoni (Lukan), Kurt e Dik Spata (Grykë Nokë), Mehmet (Dedja) Skepi e Daci i Kalisit, etj., etj. Një ansambël figurash e Dyersh të fuqishme, vërtet ashtu siç i quante Edith Durhami, "Tigrat e Dibrës". Këta bënë Kryengritjen antiserbe të shtatorit 1913, Kuvendin e Arrasit, Kryengritjen antiserbe të 15 gushtit 1920 dhe, të gjithë bashkë, Dibra e Madhe e Dibra e Vogël, Malësia e Topalltia, paria e halia (vegjelia), më mend e me kuvend, me krisma e me pushkë, me gjak e me djersë materializuan vendimet e Lushnjës për pavarësinë dhe integritetin e Shtetit Shqiptar dhe u bënë shtylla të shtetndërtimit e të kombformimit shqiptar në vitet 1920-1939.

P. S. Edhe Tiranën kryeqytet e bëri Zogu. Në fillim, "të përkohshëm, se ashtu e solla puna" dhe më pas të "përhershëm" e me rrugë e rregulla Kushtetuese. Kongresi i Lushnjës nuk di të ketë diskutuar problemin e kryeqytetit dhe të ndryshimit të tij. (Shënim: Mosmirënjohja është kryevesi i veseve).

Shkodër, 10. 02. 2020 - Mbajtur në veprimtarinë shkencore të organizuar me 11 shkurt 2020 në sallën e Teatrit Kombëtar Tiranë organizuar nga Shoqata "Bashkimi Dibran" me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet i Shqipërisë.

"TIRANA, 100 VJET KRYEQYTET", ME SHTATË KRYEBASHKIAKË DIBRANË

Në një shekull kryeqytet, Tirana është qeverisur nga shtatë kryebashkiake e prefektë që kanë dalë nga komuniteti dibran. Duke pohuar me krenari këtë testament historik, Prof.Dr.Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, njëherësh Kryeyar i Shoqatës Bashkësisë Dibrane, në fjalën e hapjes së Simpoziumit Shkencor "Tirana një shekull kryeqytet", ndër të tjera tha se "Nga komuniteti ynë dibran kanë dalë disa kryetarë bashkie dhe prefektë, duke filluar nga personalitete si Qamil Pepa, Rexhep Jella, Izet Shatku, Ali Erebara, Edlira Haxhiymeri, Jashar Mezenxhiu dhe i fundit dibran Lulzim Basha".

Në këtë Simpozium të organizuar nga Shoqata "Tirana Intellectum" dhe Shoqata Bashkësisë Dibrane, më 11 shkurt 2020 në sallën e shfaqjeve të Teatrit Kombëtar, mori pjesë dhe përshëndeti edhe Presidenti i Republikës SHT Z.Illir Meta.

Pasi ndoqi koncertin festiv, si dhe dokumentarin kushtuar Tiranës, Presidenti i Republikës në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, vuri në dukje se 100 vjetorit i Tiranës kryeqytet është një ditë e shënuar për qytetarët e Tiranës, Shqipërisë dhe për mbarë kombin shqiptar.

"11 Shkurti është një ditë e veçantë për të gjithë ne, është dita e inaugurimit të Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë. Ndiem i lumtur që jemi bashkë në këtë atmosferë festive dhe nga zemra uroj qytetarët e Tiranës dhe mbarë shqiptarët kudo ndodhen", u shpreh kreu i shtetit shqiptar. Presidenti Meta tha se e kishte pritur me shumë kënaqësi idenë për të nderuar nëpërmjet një simpoziumi shkencor kontributin shekullor të shumë brezave, atdhetarëve dhe bijve të shquar të Tiranës.

"Edhe pse kanë kaluar njëqind vjet nga 11 Shkurti i vitit 1920, koha vërtetoi se vendimi historik i Kongresit të Lushnjës për caktimin e Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë ka qenë një nga vendimet më të mençura dhe vendimtare për shtetformimin tonë.

Në këtë përvjetor gjej rastin të përkulem nderim të thellë për gjithë atdhetarët e shquar të Tiranës të asaj kohe, për të gjithë Këshillin bashkiak të qytetit të asaj kohe, për kryetarin e nderuar të bashkisë Ismail Ndroqi si dhe gjithë familjet tiranase që e mirëpritën dhe hapën dyert dhe zemrat për ta shndëruar qytetin e tyre në kryeqytet të të gjithë shqiptarëve.

Nga kjo konferencë e nderuar do të doja të shpreh bindjen se Tirana ia ka dalë me sukses të jetë epiqendra e jetës politike, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe sportive të vendit, si dhe të luajë me sukses rolin promotor të gjithë shoqërisë sonë.

Qyteti dikur i vogël, me arkitekturë modeste është shndërruar tashmë në metropolin ambicioz dhe qendrën më të madhe ekonomike, administrative, politike, universitare, mediatike, sociale dhe kulturore të vendit.

Përgjatë një shekulli Tirana rezultoi qyteti me transformimin më të madh urban dhe njerëzor të Shqipërisë, në të cilin sukseset, dështimet dhe sfidat e përparimit janë të lidhura me arritjet e mbarë vendit.

Kryeqyteti shqiptar hodhi shtat mbi trashëgiminë e një komuniteti vendas mjaft njerëzor, atdhetar dhe me vlera qytetare të arrira.

Traditat tiranase si bujaria, mikpritja dhe solidariteti njerëzor ishin tipare që i bashkuan shqiptarët e gjithë trojeve në një ansambël kulturor të larmishëm dhe harmonik.

Në këtë 100-vjetor ne përulemi me mirënjohje ndaj kontributit, historisë, mirësjelljes dhe vlerave etno-kulturore të komunitetit tiranas.

Kryeqytetet meritojnë jo vetëm nga pozicioni

Prof.Dr. Bujar Kapexhiu - "Nderi i Kombit":

- **Dibranët e Tiranës, mbi 107 vjet në Tiranë, nuk e kanë harruar kurrë mikëpritjen bujare dhe bamirëse të tiranasve, e cila shkon më tej duke shkëmbyer dhe lidhje familjare me njëritjetrin.**
- **Nga komuniteti ynë dibran kanë dalë disa kryetarë bashkie dhe prefektë, duke filluar nga personalitete si Qamil Pepa, Rexhep Jella, Izet Shatku, Ali Erebara, Edlira Haxhiymeri, Jashar Mezenxhiu dhe i fundit dibran Lulzim Basha.**



midis komuniteteve! Presidenti Meta vlerësoi gjithashtu Shoqatën 'Tirana Intellectum', e cila edhe pse e re, po bën një punë shumë të mirë në promovimin e artit, kulturës, traditës dhe historisë së Tiranës si dhe në evidencimin figurave të shquara të Kryeqytetit tonë.

"Do të doja në këtë përvjetor të përmendja gjithë emrat e familjeve tuaja, të cilat kanë përcjell në shekuj historinë dhe krenarinë, jo vetëm të kryeqytetit, por edhe të kombit tonë.

Por janë aq të shumta dhe të respektuara sa koha nuk do të na ndihmonte për t'i përmendur të gjithë, për më tepër që ky 100-vjetor është sipari i këtyre festimeve, pasi do të kemi edhe shumë aktivitete të tjera përgjatë këtij viti.

Për këtë arsye nga numri pafund i qytetarëve të shquar të Tiranës sot, edhe me propozimin tuaj, do të përzgjidhja për vlerësim disa prej tyre", - u shpreh kreu i shtetit shqiptar.

Me rastin e 100-vjetorit të Tiranës si kryeqytet, Presidenti i Republikës vlerësoi (pas vdekjes) me Titullin "Karlors i Urdhrit të Skënderbeut" Kryetarin e parë të Bashkisë së Tiranës Kryeqytet, Ismail Ndroqi (pas vdekjes), si dhe rilindasit e shquar Said Sermedin Toptanin.

Gjithashtu Kreu i Shtetit vlerësoi me Titullin "Naim Frashëri", humanisten e njohur tiranase Hatixhe Skënderi, me Titullin "Mjeshtër i Madh" këngëtarin simbol të këngës tiranase Hafsa Zyberi (pas vdekjes), si me Titullin "Për Merita të Veçanta" atdhetarin dhe mësuesin e shquar Ethem Tabaku (pas vdekjes).

Ndërsa me Titullin "Mjeshtër i Madh" u nderua studiuesi dhe historiani i njohur tiranas, Gazmend Baku, libri i të cilit "Tirana e vjetër" u përrua gjatë veprimtarisë përkujtimore historiko-kulturore.



gjeografik, por edhe bazuar mbi traditat, monumentet historike, vlerat kulturore dhe cilësitë njerëzore të banorëve të saj.

Ne jemi të vetëdijshëm, se në historinë 100-vjeçare të Tiranës, krahas arritjeve është dëshmuar për fat të keq edhe nxitimi, egocentrizmi dhe papërgjegjshmëria për t'u ngritur dhe shkelur mbi vlerat e të parëve tanë të nderuar.

Tirana është ndërtuar në një nga trevat më të pasura me vlera antike e mesjetare, e rrethuar me 14 forteza që i japin kësaj treve vlera të pallogaritshme monumentale e etno-kulturore. Ndër vite këto vlera janë shtrirë dhe në territorin e kryeqytetit duke pasqyruar traditat dhe kërkesat estetike dhe arkitekturore të shumë gjeneratave", -u shpreh Presidenti i Republikës. Zoti Meta vlerësoi faktin e organizimit të këtij manifestimi përkujtimor në ambientet e Teatrit tonë Kombëtar, kësaj pasurie kulturore të pazëvendësueshme të jetës shpirtërore të kryeqytetit dhe mbarë kombit tonë.

Ky gjest, sipas tij është një thirrje në lartësinë e shekullit për të ruajtur e mbrojtur trashëgiminë e pasurisë arkitektonike e kulturore të kryeqytetit ndër vite!

Duke përshëndetur kurajën qytetare dhe duke konfirmuar mbështetjen time të vazhdueshme, kreu i shtetit tha se brezi i ri i Tiranës duhet të njihet dhe t'i përkushtohet pasurisë shpirtërore dhe traditave më të mira kulturore të kryeqytetit tonë.

"Duke hedhur vështrimin në vite konstatojmë me kënaqësi se nuk ka arritje dhe përpjekje shqiptare për liri në të cilën Tirana të mos ketë atdhetarët, prijësit poredhe dëshmorët e heronjtë e vet.

Tirana u bë qyteti i barrkadave në vitet e luftës për çlirim, sikurse dhe lokomotiva e përparimit tonë shoqëror, ekonomik e kulturor.

Në të gjithë fushat e jetës, në arsim, shkencë, art, sport, kulturë dhe folklor, komuniteti i Tiranës është ndër më të shquarit.

Tirana është epiqendra dhe lokomotiva e lëvizjeve politike, e aspiratave për demokraci dhe aktiviteteve për emancipim shoqëror.

Tirana përbën potencialin më me vlerë të mendimit të përparuar, të energjisë rinore dhe kapaciteteve intelektuale.

Ajo është modeli dhe prijësja që i udhëheq shqiptarët drejt demokracisë, shoqërive perëndimore dhe aleancës euroatlantike", -tha Presidenti Meta. Ai vlerësoi me këtë rast edhe solidaritetin në këtë aktivitet të Bashkësisë Dibrane dhe artistëve të Teatrit Kombëtar! Një gjetje e lartë, ky sipas tij, bashkëpunimi e respekti



Ngjarja ka ndodhur gjatë natës, ndërsa tragjedia është zbuluar paraditen e 14 shkurtit 2020

fatkeqësia

Tragjedi në familjen Tola në Ostren. Humbin jetën nëna me dy fëmijë

Tragjedi në Familjen Tola në Ostren të Bulqizës. Nëna, Rajmonda, bashkë me dy fëmijët, Rudinën 18 vjeçe dhe Fajtonin 14 vjeç, kanë humbur jetën në rrethana ende të paditura. Ngjarja ka ndodhur gjatë natës, ndërsa tragjedia është zbuluar paraditen e 14 shkurtit 2020. Ka qenë kunata e Rajmondës ajo që ka zbuluar tragjedinë, pasi kur shkoi t'u hidhte bagëtime për të ngrënë rreth orës 11:30, trokiti në derën e familjes dhe askush nuk iu përgjigj. Pas tentativave për të hapur derën, ajo njoftoi fqinjët e saj, të cilët me forcë hynë brenda, por u përballën me skenën e rëndë. Rajmonda bashkë me dy fëmijët kishin ndërruar jetë në banesë, ndërsa vajza e vogël kishte shenja jete dhe u transportua në spital. Nëna me 3 fëmijët jetonin të vetëm, pasi burri ishte emigrant në Greqi.



TRE JETË TË HUMBURA NGA E NJËJTA FAMILJE

Familjarët, të afërmit dhe banorët e fshatit Ostren, në Bulqizë, ju dhanë lamtumirën e fundit nënës me dy fëmijët e saj, vajzës dhe djalit, të cilët humbën tragjikisht jetën më 14 shkurt 2020.

Ato u përcollën në banesën e fundit nga mijëra banorë nga e gjitha zona e Gollobordës.

Ngjarja ka tronditur familjarë e të afërm, por edhe mbarë opinionin publik, ndërsa nuk dihet ende shkaku i vërtetë i vdekjes së trefishtë.

Rudina, e cila do ta kurorëzonte dashurinë e saj me një banor të fshatit fqinj me Ostrenin, mbante veshur fustanin e nusërisë, jo për në altar, por fatkeqësisht për në banesën e fundit. Fajton Tola 14-vjeç, më 14 dhe 15 shkurt do duhet të ishte në shkollë bashkë me shokët dhe shoqet e klasës. Por të shtunën e 15 shkurtit, ata me lule në dorë kanë shkuar në shtëpinë e tij për ta përcjellë për në banesën e fundit, duke i shprehur ngushëllimet familjarëve të tij. Fatjoni bashkë me nënë Rajmonda 45-vjeç dhe motën Rudina vdiqën të asfikuar nga tymi i sobës me dru, me të cilën po ngroheshin.

Familja ka hapur dyert e mortit,

dhe trupat e pajetë u përcollën për në banesën e fundit. Për të lehtësuar sadopak dhimbjen, shpenzimet për ceremoninë mortore u mbulohen nga Bashkia e Bulqizës, ndërsa për të shprehur ngushëllimet në familjen Tola ishte edhe kryebashkiaku Lefter Alla.

NË FSHATIN ZAPOQ TË OSTRENIT MBIZOTËRON ZIA, LOTËT E DHIMBJA

Në fshatin Zapoq të Ostreni, ku ka ndodhur tragjedia, mbizotëron zia, lotët e dhimbja. Tre jetë të humbura nga e njëjta familje.

Ditën e 14 shkurtit, Fatjon Tola duhej të kishte hapur derën e shtëpisë për të shkuar në shkollë ku vazhdonte klasën e tetë. Mungesa e tij vuri në lëvizje të afërmit e familjes Tola, fqinj në fshatin Ostren të Bulqizës, duke trokitur në familjen e Ylberit. Por nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Kunata e shtëpisë, ka kërkuar ndihmën e fqinjëve të tjerë, ku pasi kanë hapur derën me forcë, kanë mbetur të shtangur. Rajmonda dhe dy fëmijët e saj, Fatjoni 14-vjeçar dhe Rudina 22 vjeç, e cila këtë shtator do të martohej, ishin të pajetë! Në mesin e kësaj dhimbje të papërshtueshme, sytë e shpresës u kthyen

nga vajza tjetër e shtëpisë, Merita, 16-vjeçare, e cila kishte shenja jete. Për kryefamiljarin Ylber Tola, i cili ishte në Greqi si emigrant ku bënte punë sezonale vajtje-ardhje, telefonata e asaj dite (14 shkurt 2020) nga të afërmit, do të ishte më tragjika në jetën e tij. Ai mori lajmin se bashkëshortja e dy fëmijët humbën jetën mbi dyshimet se janë asfikuar nga tymi i sobës me dru me të cilën ngroheshin, ndërsa mrekullisht, Merita e kaloi rrezikun për jetën pas ndihmës mjekësore që mori në Spitalin e Traumës në Tiranë.

Kthimi në atdhe nuk ishte aspak i lehtë për Ylberin. Do duhej tu jepte lamtumirën më të hidhur. Thotë se nuk e di më se çfarë ndjen, përveç boshllëkut të pazëvendësueshëm që i lë humbja e njerëzve të zemrës. Megjithatë, atij i mbetet të bëhet i fortë, për vazhjen tjetër që ia hodhi kësaj tragjdie, por edhe për vajzën më të madhe, e cila është e martuar. Mbi të gjitha për 16-vjeçaren, e cila ende nuk e ka mësuar se nëna, motra dhe vëllai i saj i vogël nuk mundën të mbijetojnë brenda të njëjtave mure prej nga ajo doli e gjallë. Me gjithë mallin për fëmijët dhe lodhjen nga puna në një shtet të huaj, nuk ndihet fajtor që ka qëndruar larg familjes, pasi nëse nuk do të kishte punuar në emigrim, siç Ylberi thotë - "asgjë nuk do të kishim bërë".

E AFËRMJA E TRE PERSONAVE QË U SHUAN: MË DHEMB SHPIRTI, TRI KUFOMA NË NJË SHTËPI! LINDËN DHE VDIQËN NË FSHAT

E afërmja e vetme që ndodhet pranë Merita Tolës në spitalin e Traumës në Tiranë, është nusja e

dajës së Rajmondës, e cila ndërroi jetë së bashku me dy fëmijët e tjerë të saj në banesën e tyre në Ostren të Bulqizës. Lumturie Bajrami thotë se lajmin tragjik e ka marrë edhe bashkëshorti i Rajmondës, që ndodhet emigrant në Greqi, dhe ka marrë rrugën për në atdhe, për t'i dhënë lamtumirën e fundit familjarëve të tij. Zonja Bajrami thotë se nuk e di se çfarë ka ndodhur në banesë që i mori jetën nënës dhe dy fëmijëve, por kërkon ndihmën e shtetit në një familje që kanë për të varrosur tre persona!

"E mora vesh përmes televizorit, dhe sa pashë emrin e mbesës në televizor, mora në telefon kunatin e mbesës, dhe tha po është e vërtetë. Si ka ndodhur i thash? Nuk dimë asgjë, 3 janë të vdekur, dhe një në spitalin e Bulqizës. Unë u nisa direkt në spital. Komunikova me infermieren, për momentin është mirë më thanë. Jemi të traumatuar, i thonë 3 kufoma. Rajmonda ishte shtëpiake. Bashkëshorti në Greqi në emigrim me tre mujorsha, vajtje-ardhje. E kanë marrë në telefon edhe atë, është nisur nga Greqia. Kufomat i kanë çuar në Peshkopi të bëjnë ekspertizën. Aty përdornin zjarr për ngrohje se janë në mes të fshatit, por të vërtetën nuk e di se çfarë mund të ketë ndodhur. I mora në telefon, aty kishte vetëm të qara. Më dhëmb shpirti. Me bagëti merren, nuk kanë gjendje të mirë, të kishin gjendje të mirë nuk shkon burri në Greqi emigrant me i lënë fëmijët. Ndiha nga shteti është mëse normale se është gjendje shumë e rëndë, tre kufoma në një shtëpi. Janë në gjendje kritike, në mes të fshatit, jetojnë me sakrificë të mëdha. Ata kanë lindur dhe po vdesin në fshat. Aty kanë jetuar", tha Lumturie Bajrami.

BASHA: E NDOQA LAJMIN ME DHIMBJE, SHËRIM TË SHPEJTË VAJZËS TJETËR

Kreu i Partisë Demokratike ka reaguar në lidhje me tragjedinë e ndodhur në Bulqizë, ku një nënë me dy fëmijë gjetën vdekjen. Basha shpreh ngushëllimet për familjen Tolaj si dhe i ka uruar shërim sa më të shpejtë pjesëtarit tjetër të familjes, që sipas kreut të opozitës është vajza tjetër e familjes.

"Me tronditje dhe dhimbje ndoqa lajmin për tragjedinë në Ostren të Bulqizës ku humbën jetën një nënë dhe dy fëmijët e saj. Shpreh ngushëllimet e mia të thella për familjen Tolaj dhe uroj shërim të shpejtë vajzës tjetër të familjes që po merr ndihmën mjekësore" shkruan Basha.

Presidenti Meta viziton në Spitalin e Traumës 16-vjeçaren e mbijetuar nga Ostreni: Do jem pranë tyre në këtë dhimbje të pangushëllueshme

Presidenti Ilir Meta ishte në spitalin e Traumës në Tiranë, për t'u interesuar për gjendjen shëndetësore të vajzës 16-vjeçare, e cila i mbijetoi tragjedisë në Ostren të Madh të Bulqizës ku humbën jetën nëna, motra dhe vëllai i saj.

"Për fat të mirë gjendja e Meritës, vajzës nga Bulqiza është e mirë dhe e qëndrueshme dhe mjekët po bëjnë një punë shumë të mirë për ta mbajtur jashtë çdo rreziku. Sikurse dimë ka ndodhur një dramë shumë e madhe në familjen e saj. Shpreh ngushëllimet më të ndjera për gjithë familjen Tola, për komunitetin e Ostrenit dhe Bulqizës,



dhe siguroj që do të jem gjithmonë pranë tyre për të kaluar këtë dhimbje të jashtëzakonshme dhe të pangushëllueshme", tha Meta.

Detaje të reja rreth tragjedisë, ekspertët gjejnë në banesë një shishe me pesticide

Mbetet ende e paqartë ajo që qëndron pas tragjedisë në familjen Lala në fshatin Ostren të Bulqizës, ku humbën jetën tre pjesëtarë, ndërsa në spital gjendet edhe një vajzë. Grupi hetimor ka gjetur pranë banesës një shishe të vogël 50 gramësh. Sipas Neës24, shishja çlironte aromë të rëndë. Familjarët thanë se ajo mbante pesticide për patatet, ndërsa është dërguar për ekzaminim në laborator për të zbuluar nëse ishte ajo shkaku që i mori jetën Rajmonda Tolës, vajzës së saj Rudinës dhe djalit Fationit.

Biznesmeni është përplasur nga një makinë tip "Ford", e për pasojë ka humbur jetën. Ndërsa qytetarët të cilët banojnë në afërsi të kësaj rruge tregojnë se aksidentet në këtë zonë kanë qenë të shpeshta...

Homazh për biznesmenin Murat Duriçi

Një aksident i rëndë, me pasojë vdekjen e 53 vjeçarit Murat Duriçi ndodhi mbrëmjen e së premtes të 31 janarit, në aksin rrugor Qafë e Buallit-Vajkal, në vendin e quajtur Vajkal 2. Sipas policisë lokale të Bulqizës, bëhet me dije se 53 vjeçari Duriçi po ecte në këmbë përgjatë këtij segmenti rrugor, ku dhe mendohet të jetë goditur nga një automjet tip Ford, i cili drejtohej nga Mentor Ceku, duke e lënë në gjendje të rëndë në anë të rrugës. Burime nga policia bëjnë me dije se i aksidentuari është gjetur me shenja jete nga kalimtarët e rastit, të cilët kanë njoftuar menjëherë policinë. Fillimisht i aksidentuari është dërguar për në spitalin e Bulqizës, por plagët e rënda që kishte në trup, detyruan mjekët ta dërgojnë drejt spitalit të traumës në Tiranë. Por ndonëse i aksidentuari u dërgua në Tiranë për një mjekim më të specializuar, nuk mundi t'ju mbijetojë plagëve të mar-

ra. Ndërkohë burime nga policia bëjnë me dije se drejtuesi i automjetit, i cili dyshohet si autor i këtij aksidenti ishte larguar nga vendi i ngjarjes, ku më pas është bërë i mun-

dur arrestimi i tij, si dhe gjetja e automjetit me të cilin kishte shkaktuar aksidentin. Në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, biznesmeni Murat Duriçi figuron si më poshtë:

Nipti:L37125401E;
Emri i subjektit:"KELI-M-13"

Objekti i Aktivitetit: Import-eksport si dhe tregëtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme, Kërkim, zbulim, nxjerrje, prodhim, shfrytëzimit dhe tregëtim të mineraleve të ndryshme metalore dhe jo metalore (krom etj), me shumicë e pakicë.

Duriçi rezulton një person që nuk njihet për të shkuar të dyshimtë apo të lakuar në ndodnjë çështje konflikti



si dhe rezulton gjithashtu pa precedent penal.

Policia sqaron se biznesmeni është përplasur nga një makinë tip "Ford", e për pasojë ka humbur jetën. Ndërsa qytetarët të cilët banojnë në afërsi të kësaj rruge tregojnë se aksidentet në këtë zonë kanë qenë të shpeshta, jo vetëm në njerëz por edhe në bagëti, kjo për vetë faktin se drejtuesit e atumjeteve ecin me shpejtësi të madhe, duke mos marrë parasysh se ky

aks kalon në qendër të banuar. Që prej ndërtimit, aksi rrugor Qafë e Buallit-Vajkal ka qenë burim aksidentesh, të cilat kanë çuar edhe në humbje jetë njerëzish.

Familja Koxha, jetesë në kushtet e varfërisë ekstreme

Një familje në fshatin Gjoricë të Njësisë Administrative Gjoricë, prej vitesh po jeton në kushte mjaft të vështira. Bëhet fjalë për familjen e Adil dhe Selvie Koxhës, bashkë me pesë fëmijet e tyre. Përveç kushteve të vështira, çifti Koxha kanë edhe probleme me shëndetin. Kësaj familje i mungojnë kushtet më minimale për jetesë, përfshirë edhe atë të një banese për të futur kokën, pasi aktulisht banesa e tyre, jo vetëm që nuk plotëson asnjë nga kushtet normale për jetesë, por është edhe tërësisht e rrënuar dhe amortizuar. Gjithë të ardhurat e kësaj familje përmblidhen vetëm 95 mijë lekë të vjetra që marrin nga Bashkia Bulqizë. Kushtet e vështira të kësaj familje kanë detyruar fëmijët që të ndërpresin edhe shkollën. Të vetmit që shkojnë me ndërpreje për shkak se nuk i përballojnë dot janë vetëm dy fëmijet e vegjël të kësaj familje. Në banesën ku jetojnë tani janë munduar të improvizojnë një kuzhinë, ku sipër sobës nuk ka asgjë për të gatuar, përveç një tepsie me bukën e fundit. Çdo gjë në këtë familje vret. Pa banjo, dritare pa xhama, por me plasmas dhe kompesata, pa shtresa fjetje, vetëm

një dhomë krejt e nxirë. Kjo gjendje ngjall veçse trishtim, ku përveç varfërisë u duhet të përballen edhe me temperaturat e ulëta të këtij dimri të egër. Selvija e cila nuk është e aftë për punë tregon se kushtet e familjes së saj janë mjaft të vështira. Kudo pikon çatia, shprehet ajo, ndaj kërkon ndihmë. I afërmi i tyre, Neki Miftari, shprehet se familja ka nevojë për një shtëpi të re, pasi është në varfëri të tejskashme. Të vetmen banesë ku po jeton kjo familje e kanë ndërtuar vetë banorët, ndaj bën thirrje që shteti të marrë masa, pasi kjo familje po rrezikohet çdo ditë. Zhuljetata Deda, drejtoreshë e Shërbimit Social pranë Bashkisë Bulqizë pranon që kjo është një familje ekstremisht në nevojë. Ajo pohon se bashkia i ka dërguar një shkresë Drejtorisë së Financave për t'i larguar nga ajo banesë, duke i dërguar ato në një banesë, ku bashkia ka në projekt për rehabilitimin e kësaj familje dhe të tjerave në nevojë. Ndër të tjera drejtoresha Deda u shpreh se vetë kryetari i Bashkisë ka marrë përsipër mbështetjen për ndërtimin e një shtëpie të re për këtë familje.



RRUGA E GOLLOBORDËS GATI E PAKALUESHME

Fshatrat e Bulqizës vijojnë të përballen me gjendjen e amortizuar të rrugëve që i lidhin ato me qendrat urbane. Kjo është rruga që lidh fshatrat e Gollobordës me rrugën nacionale. Kjo rrugë e cila përdoret edhe për të kaluar në shtetin e Maqedonisë së Veriut, sipas drejtuesve të mjeteve



dhe banorëve nuk mirëmbahet. Gropat e mëdha të shfaqura në të gjithë gjatësinë e kësaj rruge e bëjnë kalimin në të, tepër të vështirë. Banorët thonë se prej 4 vitesh, askush nuk ka ndërhyrë më për riparimin e saj.

Më problematike situata paraqitet gjatë stinës së dimrit, kur ka reshje shirash apo dhe ngrica, e në këtë mënyrë kalimi në të në shumë segmente bëhet pothuajse i pamundur. Aksi në fjalë përdoret edhe për të lidhur dy njësitë administrative atë të Bulqizës dhe Librazhdit, por Autoriteti rrugor Shqiptar nuk është kujtuar ndonjëherë për këtë rrugë.

MUNGOJNË BANJOT E SHKOLLËS, NXËNËSIT PËRDORIN AMBIENTIN

35 nxënës të shkollës anekse "Zenepe Miftari" në fshatin Çerenec i Posh-tëm në Bulqizë, detyrohen që për nevoja personale të shkojnë në shtëpi apo të përdorin natyrën përreth godinës. Shkolla në fjalë ndonëse ka kushte të mira për mësimnxënie, ka mungesë të nyjeve san-



itare, duke u kthyer në problemin më të madh të fëmijëve nga kopshti deri në klasën e pestë. Vetë fëmijët tregojnë se për nevojat e tyre, ata detyrohen të shkojnë në shtëpi kush i ka afër e të tjerët të përdorin ambientet përreth. Për prindërit e nxënësve që frekuentojnë këtë institucion arsimor, gjendja është e papranueshme në

vitin 2020. Ata thonë se kërkesat e tyre ndaj pushtetit vendor, kanë rënë në vesh të shurdhër. Nga ana tjetër, prindërit shprehen se për këtë problem kanë vënë në dijeni edhe Zyrën Vendore Arsimore Bulqizë. Fëmijët e këtij aneksi shkol-lor, pavarësisht kushteve të motit, ata përdorin natyrën për nevojat e tyre.

Shtatëdhjetë vjet më parë, në "Ahishtën e madhe" të Malit të Duriçit, shpërthimi i parë i minave që thërmonin shkëmbin e gurit me xixa sinjalizoi fillimin e punës për nxjerrjen e mineralit të çmuar të kromit në Bulqizë.

Në Bulqizë 18 shkurtin e quajnë festën e minierës. Në fakt, kjo ditë konsiderohet si data zyrtare e krijimit të Minierës



HALIL RAMA

Shtatëdhjetë vjet më parë, në "Ahishtën e madhe" të Malit të Duriçit, shpërthimi i parë i minave që thërmonin shkëmbin e gurit me xixa sinjalizoi fillimin e punës për nxjerrjen e mineralit të çmuar të kromit në Bulqizë. 18 shkurti i vitit 1948 shënon kështu krijimin zyrtarisht të minierës më të madhe të kromit në vend. Pikërisht mbi luginën e Vajkalit, e cila në analet e historisë tonë kombëtare ka hyrë si një nga sheshbetejat kryesore kundër pushtuesve turq, të udhëhequra nga Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, miniera e sapokrijuar do ta bënte edhe më të njohur këtë luginë ku do të hidhte shtatë qyteti minator në prehër të maleve, nga thellësia e të cilave do të nxirreshin mbi 15 milionë tonë krom. (Në vitin e parë të punës në minierën e Bulqizës u prodhuan 10482 ton mineral kromi). Është kjo sasi tepër e konsiderueshme e mineralit të çmuar, që jo vetëm ka mbajtur peshën kryesore të ekonomisë tonë kombëtare, sidomos në katër dekada të sistemit monist, por edhe minerali me të cilin Shqipëria ka "pushtuar" tregjet e botës...

Shtatëdhjetë vjet më parë, në lartësinë 1000m mbi nivelin e detit, ishin tetë punëtorë nga Rubiku dhe trembëdhjetë punëtorë nga zona e Bulqizës që i dhanë emrin minierës së kromit Bulqizë. Në kronikat e kohës, por edhe në librat studimorë e historikë të autorëve të njohur, si Hamza Gurra, Ymer Keta, Jorgo Kola e Bashkim Lami janë skalitur emrat e minatorëve e specialistëve të parë: Osman Loshaj, Tosum Spahiu, Myrteza Duriçi, Gjergj Prenga, Sulejman Ruta, Hamit Duriçi, Liman Zogu, Adem Hasa, Gjini Kola, Pal Deda, Riza Duriçi, Din Hoxha, Mexhit Voci, Hysni Duriçi, Mustafa Duriçi, Liman Kola, Baftjar Fida, Ferit Lala, Haxhi Xhari, Abdulla Mehmeti, Ramadan Voci, Isuf Sula, Isuf Hoxha, Mehmet Keta, Dhimitër Kalam, Hamit Beta, Mehmet Kola, Hasan Jashari, Beqir Xhemali, Nazmi Përçkolla, Bajram Xheka, Tahir Nasuf Spahiu, Faredin Shehu, Mendu Qatja, Kamberr Duriçi, Uke Murrja, Ndue Tusha, Ndue Murrja, Muharrem Stafa, Dodë Preng Gjeta, Llesh Luli e Pjetër Shurbi, si dhe i Drejtori të parë të Ndërmarrjes Miniera e Kromit Bulqizë, Jorgji Traja.

Janë pikërisht këta heronjtë e parë që do të shtrinin trasenë nga ku do të ecnin qindra mijëra të tjerë, të cilët në 72 vite do të me prodhimin kryenin mbi 100 mijë km punime minerare.

PAK HISTORI

Në Bulqizë 18 shkurtin e quajnë festën e minierës. Në fakt, kjo ditë konsiderohet si data zyrtare e krijimit të Minierës së Kromit "Todo Manço", por zanafilla e saj është shumë më e hershme. Gati një shekull më parë, burri i mençur i Vajkalit Baba Fejza, do t'i porosiste bashkëshatarët e tij që ta ruajnë të mos ua grahisin gurin e zi me xixa që është më i rëndë se të tjerët dhe që do të vlerësohet shumë

72 vjet më parë - Si

- *Miniera i ka dhënë emër Bulqizës, sepse minerali kromit i nxjerrë nga nëntoka e saj ka pushtuar tregjet e botës dhe ka krijuar tek të huajt, imazhin e një qyteti dhe treve shumë të zhvilluar. Ndërsa, zhgënjimi i qytetarëve të saj qëndron në faktin se minerali kromit është përdorur për të investuar në zonat e tjera të vendit dhe jo në vetë minierën dhe Bulqizën...*



vjet më vonë... Dhe profecia e tij doli. Megjithatë kromi hyri në përdorim industrial relativisht vonë interesimi për të është i hershëm. Vendasit thonë që Italia me Serbinë janë konfliktuar ashpër për vendosjen e kufirit, të cilin Serbia e kërkonte në Qafë të Buallit kurse Italia e kërkonte në Fushë-Bulqizë. Pra, secili shtet kërkonte ta përfshinte në territorin e pushtuar prej tij. Kjo ka ndodhur në vitin 1918.

"Që në vitin 1918 ka njoftime se në Bulqizë kishin ardhur specialistë italianë që kërkonin krom. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore italianët filluan prodhimin e kromit sigurisht në sasi shumë të vogla, që i transportonin me mushka. Ndoshta kjo e bëri të detyrueshme ndërtimin e rrugës automobilistike nga Klosi në Bulqizë, e cila u lidh me rrugën automobilistike të Zerqanit, që ishte ndërtuar në vitin 1932. Në këtë kohë italianët kishin instaluar një repart ushtarak në mbrojtje të minierës", shkruan ing. Hamza Gurra në librin e tij "Bulqiza, një minierë me histori". Në vitin 1943 çeta partizane e Dibrës e sulmoi me armë dhe i përzuri italianët dhe që nga ajo kohë punimet për nxjerrjen e kromit u pezulluan, për të rifilluar më 18 shkurt 1948 kur zyrtarisht u krijua miniera e Bulqizës. Për 72 vite që nga ajo datë historike Bulqiza mbajti në kurriz një pjesë të madhe të buxhetit të shtetit. Por shumë pak u bë për vetë Bulqizën. Miniera është vërtet një vepër gjigande që e bënë mijëra burra dhe ajo u dha emër shumë prej tyre. Askush nuk e ka llogaritur saktë fuqinë krijuese të njerëzve e cila, e vënë në përdorim herë e herë e veç e herë së bashku krijoi qytetërimi të mahnitshme në botë, kështu pak nga pak u krijua edhe miniera e Bulqizës.

Me moton "kromi çan bllokadën", pothuajse nomenklatura e kuqe e vuri Bulqizën në epiqendrën e platformës së saj për shfrytëzimin barbar të kësaj pasurie të çmuar nëntokësore. Bllokmenët dirigjorin që nga Tirana, por herë-herë detyroheshin të zbrisnin edhe vetë në qytetin e ftohtë në zemër të maleve për të mbajtur nën presion administratën dhe minatorët, që me çdo kusht të realizonin planin e parashikuar prej tyre. Më e dukshme kjo strategji në vitet 1980-1990 kur vetëm në zonën

veriore janë hapur 8 puse vertikale dhe 8 dishenteri. Përveç këtyre janë hapur 4 puse ndihmës si A2 i pa përfunduar, 9/5;8/5;10/12;11/14, i cili përdoret për rrugëdalje. Gjithsesi, ai që është vonuar shumë është thellimi i pusit Nr. 7 sipas projektit. Në zonën D janë hapur 3 puse që lidhin punimet nga traverbanku C (1440) deri në Galerinë 1050.

Konkretisht: Pusi Nr. 4 që lidh Galerinë A, Galerinë 16(1160) dhe Galerinë 1050; Pusi Nr. 5 që lidh Galerinë C (1440); Galerinë 12(1360); Galerinë B (1280) dhe Galerinë A (1200). Është edhe Pusi Nr.5A që lidh Galerinë 1280(B) me Galerinë 1200(A). Veç këtyre janë hapur shumë fornele ndihmës që kanë shërbyer për transport minerali dhe për rrugë dalje e ajrim.

DISA NGA DREJTORITË E SHËRBIMET NDIHMËSE

Duke ecur në gjurmët e historisë së minierës, një stacion i rëndësishëm është padyshim shërbimi gjeologo-markshejderik i saj, i cili merr jetë në harkun kohor të viteve 1954-1955. Në krye të këtij shërbimi ishte ing. Skënder Dede dhe gradualisht filloi të plotësohej me teknikë markshejdera si Elmaz Sulika, Ismail Kurcani e Veli Lala. Teknikë gjeologë ishin Neim Çevani, Xhevdet Kuçi, Alqi Premti. Në janar 1955 zgjodhën Ferit Allën Kryetar Ekspedite, detyrë të cilën e plotësoi me sukses dhe po në këtë vit e emëruan Drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike Bulqizë.

Një minierë është pa perspektivë, nëse nuk i paraprihet më zbulimin e rezervave minerare. Këtë mision historik këtu do ta kryente më së miri Ndërmarrja Gjeologjike e Bulqizës, e krijuar që në vitin 1957, duke kryer punime për zbulimet gjeologjike për gjetjen e vendburimeve të mineraleve të dobishme dhe punime shkencore në fushën e gjeologjisë.

Nga studimi tejet shkencor, por edhe skurpuloz i z.Bashkim Lami (BULQIZA NDËR VITE) mësojmë se Drejtori parë i Ndërmarrjes Gjeologjike e Bulqizës ishte Ferit Alla, i cili siguroi mbështetjen e fortë të personelit inxhiniero-teknik që e quante themelin e sukseseve që synonte gjeologjia me inxhinierët: Virgjil Buda,

Rexhep Shehu, Xhelil Karkana dhe teknikët e rinj: Enver Vorfi, Nexhat Lami, Gani Gurra, personel organizativ: Ali Hida, Ismail Loshaj, Hasan Loshaj, Rakip Karaj, Ibrahim Balla, Pal Bilaçi, Rushit Toçi, Sulë Kica, etj. Pas një viti ndërmarrja kishte 82 veta personel inxhiniero-teknik dhe katërqind sondistë e punëtorë. Sukses i veçantë në këtë fillim ishte kualifikimi i disa mjeshtrave të shpimit që më pas u bënë themeli i realizimit të projekteve të kërkimit. Me një organizim të arrirë u përballuan vështirësi të mëdha të punës në terrene tepër të vështira kur transportoheshin sondat, motorët e pompat me pesha shumë të mëdha, në krahë, në terrenet e maleve të thepisura dhe pa rrugë.

Në vitet 1968-1971 u ndërtua Fabrika e pasurimit e cila u konsolidua pas vitit 1975 kur prodhimi i koncentratit u rrit në mbi 8000 ton/muaj. Minerali i varfër i galerive perëndimore të minierës së Bulqizës, Almarinës, minierës Batrës, Krastës, Klosit dhe të Qaf-Lamës dërgohej në fabrikë. Kështu fabrika merrte lëndë të parë mineral të varfër rreth 850 ton/ditë dhe prodhonte rreth 350 ton koncentrat në ditë. Minerali i varfër merrej zakonisht me përmbajtje mbi 27% dhe koncentratit dilte me mbi 48%. Fabrika është provuar me sukses në pasurimin e mbetjeve teknologjike të fabrikës së ferrokromit të Burrelit dhe në riciklimin e mbetjeve teknologjike të dambës që kanë mbi 12% Cr O.

Deri në vitet 1990 funksionoi ndërmarrja e furnizimit të punëtorëve që administronte tregtinë, mensat e punëtorëve dhe fjetoret e punëtorëve beqarë, duhet thënë drejt: bëheshin përpjekje por shërbimi ishte shumë i dobët. Në radhë të parë kishte mungesa të mëdha në furnizim, mungonte qumështi, mishi, zarzavatet, frutat, veshjet dhe pajisjet elektroshtetpiake. Si ndërmarrje në mbështetje të minierës ndërmarrja e furnizimit nuk i përballonte detyrat. Në fillim të viteve '90, në mbështetje të minierës u krijua edhe parku automobilistik i Bulqizës që kryesisht ishte në shërbim të transportit të punëtorëve të minierës, por edhe të transportit të kromit transit brënda minierës e për në fabrikën e pasurimit dhe të transportit të mineralit për në Durrës.

BULQIZA:QYTET-BURG

Pa mohuar aspak kontributin e qindra mijë minatorëve, inxhinierëve e teknikëve të minierës, për vetë përqendrimin e të burgosurve në kampet e këtushme gjatë viteve të diktaturës, Bulqiza mund të konsiderohet edhe si qytet-burg. Për këtë flasin statistikat e kohës. Kështu, nëse më 1954 në Bulqizë u ngrit burgu i të dënuarve ordinerë, fillimisht me 600 të dënuar, ky kamp funksionoi për rreth 30 vjet dhe përfshinte zonat nga dishenteria e galerisë 41 e deri ndër zonën "D". Katërmëdhjetë vjet më vonë, më 1968, Bulqizës do t'i shtohej edhe burgu tek vendi ku do të ndërtohej fabrika e pasurimit të kromit. Të burgosurit ndërtuan të gjitha objektet sipas projektit deri sa filloi montimi i makinerive. Saga e të dënuarve vazhdon edhe më tej kur në vitin 1976

së Kromit "Todo Manço", por zanafilla e saj është shumë më e hershme

U krijua miniera e Bulqizës



Kampi i burgut mori edhe zonën "D". Madje, pas vitit 1976 kampi ka patur maksimumin e të dënuarve.

Një tjetër burg u ngrit më 1985 me të burgosurit që do të ndërtonin Qytetin e Ri në Bulqizë. Një nga mësuesit e shquar të Bulqizës, z.Bashkim Lami, që ka drejtuar me kompetencë e përkushtim institucione kryesore në Bulqizë e pas '90-tës, në shënimet e tij shkruan se "Ndërtimet vazhduan me ritme të shpejta dhe në vitin 1988 u strehuan banorët e parë në këtë lagje". Madje sipas tij, "burgu u përdor edhe në objekte të tjera të rëndësishme të zonës së kromeve. Miniera e Batrës dhe e Tërnovës kanë pasur kampe të dënuarish, po kështu ndërtimi i fabrikës së pasurimit dhe ndërtimi i lagjes "Qyteti i ri" është bërë me kampe të dënuarish që janë përdorur vetëm në ndërtimin e këtyre objekteve. Në 28 vite kontributi i të burgosurve ka qenë shumë i rëndësishëm".

KA MINIERË, KA QYTET. S'KA MINIERË, S'KA QYTET!

Miniera dhe qyteti janë lidhur në mënyrë të pazgjidhshme: Ka minierë, ka qytet. S'ka minierë, s'ka qytet. Këtë apostulat, të bazuar mbi historinë e qyteteve minerare në botë e ka zëbërthyer më së miri Hamza Gurra, një nga inxhinierët dhe drejtuesit e njohur të minierës së kromit dhe të Bashkisë Bulqizë. Sipas tij, Bulqiza e barakave me dërrasa e viteve '49-'50 u rrit gradualisht bashkë me minierën e saj. Në vitet 50-60 u ndërtuan disa ndërtesa njëkatëshe. Pas vitit 1960 filloi ndërtimi i ndërtesave dykatëshe dhe vetëm pas vitit 1972 nisën të ndërtohen godina banimi tre e deri pesë katëshe. Shumë njerëz këtë e lidhin me nënvleftësimin që i bënte shteti këtij qyteti dhe ish-inxhinieri e drejtuesi Gurra nuk me merr përsipër të vërtetë të kundërtën por një gjë është e qartë: Në vitet e para perspektiva e Bulqizës ishte krejt e pa sigurtë, kërkim-zbulimi i këtij vendburimi është bërë krahas shfrytëzimit dhe kërkimi nuk ka përfunduar edhe sot as në thellësi dhe as nga krahët. Prandaj dhe qyteti u rrit me zor krahas rritjes së zbulimit të rezervave. Qyteti i Bulqizës me rreth 2000 banorë deri në vitin 1955 u rrit deri në 18000 banorë në vitet 1995-2000. Krahas rritjes së qytetit u formuan edhe ndërmarrjet e institucionet e qytetit. Në vitet e para qyteti nuk kishte ndërmarrje komunale kështu që të gjitha punët komunale i bënte ndërtimi i minierës ose bëheshin me punë vullnetare.

Në vitet 1985-87 u ndërtua lagja e re e quajtur "Qyteti i ri" ku u strehuan rreth 1000 familje. Pas viteve 90 kur filloi pluralizmi qyteti u përshtat shumë shpejt me mënyrën kapitaliste të jetesës. Me ndarjen e Bulqizës rreth më vete (deri atëherë në juridiskionin e rrethit Dibër) dhe aktualisht si një nga 61 bashkitë e vendit, u strukturua mjaft shpejt administrata lokale dhe jo vetëm që nuk pati probleme por përkundrazi jetesa u përmirësua mjaft. Në mënyrë të veçantë e përmirësoi jetesën tregu privat.

Megjithatë, aktualisht qyteti i Bulqizës vuan plagën e papunësisë dhe të mungesës së infrastrukturës bashkëkohore.

INFRASTRUKTURA SOCIALKULTURORE

Ndër vite u ngrit gradualisht edhe infrastruktura socialkulturore. Më 1954 u ndërtua në qytet kinemaja me një skenë të vogël dhe me 200 vende, u montuan dy aparate projekcioni për të shfaqur filmat, një sallë lojërash bilardo e një bibliotekë. Tre vjet më vonë (1957) u ndërtua në qytet shkollë e re me 7 klasa, ku u hap shkolla 7-vjeçare e ditë ku vijonin mësimin, fëmijët e Vajkalit e të qytetit të Bulqizës dhe pas 8 vitesh, më 1965 u ndërtua në Bulqizë shkollë e re me 10 dhoma mësimi, poshtë rrugës së qytetit që plotësonte nevojat për vijueshmërinë e mësimi pasi klasat u bënë me nga dy paralele. U ngritën nga mësuesit dhe nxënësit disa terrene sportive, volejboli, basketboli e gjimnastike, të cilat shfrytëzoheshin edhe nga rinia e qytetit të Bulqizës. Në shtator 1967 u shkolla e mesme e përgjithshme pa shkëputje nga puna dhe më 1972 edhe shkolla e mesme profesionale e ditës me degën për teknikë miniere, që më pas u shtuan degët, gjeologji e shpim pusesh.

Më 1975 u vu në funksionim kinoklubi i ri me dy kate, që u financua nga ndërmarrja minierës me sallë kinemaje dhe koncertesh me 350 vende, me bibliotekë e sallë leximi, bar-kafë dhe dhoma e anekse të tjera pune, duke u krijuar kështu mundësia që në këto ambiente të gjallëroheshin aktivitetet kulturore e artistike, sesionet shkencore, recensionet, bisedat etj.. Ky pallat është rikonstruktuar dhe vazhdon të jetë si qendër kulturore e vetme e këtij qyteti.

Në vitin 1989 u ndërtua shkolla 8-vjeçare me 4 kate në "Lagjen e Re", me 24 klasa, 4 kabinete e palestër sportive.

• Zoti Edmond Isaku, themelues dhe administrator i Tv Bulqiza, njëherësh dhe administrator i një kompanie koncesionare thotë se nga shteti ka nevojë për ndërhyrje lehtësuese pasi industria e nxjerrjes së kromit, pas më shumë se shtatë dekadash me trend të pandalshëm rritës në volumin e mineralit të nxjerrë si edhe në vëllimin e lëndës së eksportuar, janë vështirësuar mjaft punimet

FRAGMENTARIZIMI I MINIERËS NË KOMPANI KONCESIONARE

Bulqiza është një trevë, e cila shtrihet në pjesën verilindore të vendit dhe përfshihet në prefekturën e Dibërës. Jeta në këtë zonë zhvillohet në dy dimensione. Në të vërtetë janë dy Bulqiza, Bulqiza që shtrihet gjeografikisht dhe Bulqiza e nëntokës..

Miniera e dikurshme e centralizuar është fragmentarizuar në qindra kompani koncesionare. Sipas Ministrisë së Energjetikës, deri në fund të 2015 kanë qenë aktive gjithsej 264 leje minerare shfrytëzimi për mineral kromi, nga të cilat tre leje janë koncesionare. Këto leje janë të shpërndara në 12 rrethe të vendit dhe në dy brezat e shkëmbinjve ultrabazikë.

Numri më i madh i lejeve të shfrytëzimit, 117 leje ose 47% e të gjitha lejeve të shfrytëzimit, ndodhet në rrethin e Bulqizës.

Në vitin 2008, ishin 68 leje shfrytëzimi, ndërsa në vitin 2013 ky numër kishte arritur në 118. Në vitin 2000 u firmos nga qeveria dhënia me koncesion e puseve të thellësisë të Bulqizës dhe të Fabrikës së Pasurimit të Kromit në Bulqizë dhe në Klos si dhe Uzinat e Ferrokromit në Burrel e Elbasan, për 30 vjet . Me këto ndërmarrje "Darfo" themeloi kompaninë "DARFO ALBANIA" më 14 prill 2000. Pas nëntë vitesh, në korrik të vitit 2009, "DARFO" i shet 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë koncesionare "DARFO ALBANIA", shoqërisë "ACR Holding" dhe pas kësaj, emri i shoqërisë ndryshohet në "Albanian Chrome" me të njëjtin NIPT.

Më 17 janar 2013 "Balfin Group", me Samir Mane si drejtues i bleu aksionet e kompanisë "Albanian Chrome" (ACR), shoqërisë "DCM DECO-metal GmbH-DCM Beteiligungs GmbH" (BIRN) dhe kjo kompani menaxhon edhe aktualisht këtë minierë. Sipas z. Mane a kjo kompa-

ni ka mbi 1 mijë punëtorë, ndërkohë që disa elementë të rëndësishëm janë siguria dhe investimi që zgjat jetën e minierës deri në 30 vjet. Kjo ishte kërkesa e parë. Në 2013 ne filluam të mendonim për pusin dhe aktualisht jemi

"Balfin Group", është në përfundim të projektit me vlerë 22 mln euro për Pusin. Sot rroga më e lartë për minatorët është 87 mijë lekë të reja, pastaj ka edhe kontribute për ushqimin dhe gjëra të tjera. Gati 1 milion dollarë në muaj është fondi i pagave.

Ndërsa vlera totale e investimit është 34 milionë dollarë. Deri në 2021 mund të shkojë në 55 milionë. Po bëhet një investim tjetër prej 14 milionë dollarë për ajrimin e minierës", ka thënë Mane para pak ditësh gjatë një debati televiziv.

NË 72-VJETORIN E MINIERËS, MINATORËT NË PROTESTË PËR STATUSIN E MINATORIT

Shtatëdhjetëdy vjet pas krijimit miniera e kromit Bulqizë nuk është më një ndërmarrje gjigande, por një sistem i tërë shfrytëzimi që ndahet në rreth 130 ndërmarrje private, gjeneruese të punësimit për shumicën e familjeve të zonës. Për këtë arsye ajo ka një rëndësi strategjike dhe duhet sjellë në vëmendje të qeverisë dhe të opinionit publik, pasi përbën një kantier të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Në sektorin e nxjerrjes së kromit, zhvillojnë aktivitetin në zonën e Bulqizës afërsisht 130 ndërmarrje private, duke qenë gjeneruesit e punësimit për shumicën e familjeve të zonës. Zoti Edmond Isaku, themelues dhe administrator i Tv Bulqiza, njëherësh dhe administrator i një kompanie koncesionare thotë se nga shteti ka nevojë për ndërhyrje lehtësuese pasi industria e nxjerrjes së kromit, pas më shumë se shtatë dekadash me trend të pandalshëm rritës në volumin e mineralit të nxjerrë si edhe në vëllimin e lëndës së eksportuar, janë vështirësuar mjaft punimet...Dhe si të mos mjaftonin këto, minatorët e Bulqizës ankohen se marrin pensione minimale në një kohë që gjithë jetën kanë punuar nëntokë, në kushte tepër të vështira shëndetësore dhe ekonomike. Ata i bëjnë apel qeverisë për të miratuar statusin e minatorit, në mënyra që jeta e tyre të jetë më pak e vështirë, ndërkohë protesta e tyre për "Statusin" vazhdon pa ndërprerje që prej disa muajsh.

Ing.Kurt Skarra që ka pasur fatin të ishte kryeinxhinier i minierës në vitet me prodhimin më të lartë të kromit mbështet protestën e minatorëve dhe me të drejtë e konsideron nëntokën e Bulqizës si përfaqësuese, si pjesë të jetës dhe dinamizmit të punës ku mesatarisht për çdo vite kanë ushtruar profesionalizmin e tyre mbi 5000 punonjës të cilët kanë ushqyer mbi 15 000 jetë njerëzish, duke i dhënë Bulqizës, emër dhe zhgënjim.

"I ka dhënë emër, sepse minerali kromit i nxjerrë nga nëntoka ka pushtuar tregjet e botës dhe ka krijuar tek të huajt, imazhin e një qyteti dhe treve shumë të zhvilluar, -thotë ing.Skarra. Ndërsa, zhgënjimi, sipas tij, qëndron në faktin se minerali i kromit është përdorur për të investuar në zonat e tjera të vendit dhe jo në vetë minierën dhe Bulqizën.

Drejtuesit e spitalit kanë marrë masat e nevojshme për mundësinë e shfaqjes së epidemisë

sociale

Sitali i Bulqizës, masa për coronavirusin

Ndonëse për momentin në qytetin e Bulqizës nuk ndodhet asnjë shtetas kinez i cili ka punuar në minierën e Bulqizës, drejtuesit e spitalit të këtij qyteti kanë marrë masat e nevojshme për mundësinë e shfaqjes së coronavirusit. Drejtori i Spitalit të Bulqizës, Hazis Jella tha se stafi ka marrë të gjitha udhëzimet e nevojshme për të specifikuar situatat e mundshme të shfaqjes së coronavirusit. Sipas Jellës për momentin në minierën e Bulqizës nuk ndodhet asnjë nga inxhinierët kinezë që kanë punuar për ndërtimin e pusit 21, por besohet që ata vijnë herë pas here për inspektim të minierës.

Për momentin në spitalin i Bulqizës po paraqiten vetëm persona me virozën e zakonshme stinore të cilët janë trajtuar sipas nevojës së tyre.



CORONAVIRUSI QË KA SHPËRTHYER NË QYTETIN KINEZ ËUHAN, ËSHTË ZGJERUAR NË DISA SHTETE TJERA

Personat e parë të infektuar me virus janë lokalizuar në një treg të peshqve në Wuhan, që ndërkohë është mbyllur shkruan Deutsche Welle. Infektimi i personit të parë ka gjasa të ketë ndodhur nga zoonoza, që do të thotë se ka pasur kontakt direkt mes kafshës dhe njeriut.

Zonozat mund të barten përmes ushqimit, për shembull duke konsumuar mish të kafshëve të ndryshme. Nëse ato ushqime nuk ruhen në temperaturat e përshkruara nga ekspertët dhe nëse janë përgatitur për konsum në kushte jo adekuate, produkte të tilla mund të jenë burim i infektimit.

ÇFARË JANË CORONAVIRUSËT?

Coronavirusët janë bërë të njohur gjatë viteve të 60-ta. Emri ka prejardhjen nga strukturat e proteinave të mbështjellësit të virusit. Këta virusë nuk janë diçka e pazakontë. Shpesh personat e infektuar kanë simptoma të ngjashme me atë të një gripi: kollitje, temperaturë dhe molisje, e shpesh edhe probleme me bark dhe diarre. Megjithatë, këta virusë mbijetojnë sepse kanë fuqi të jashtëzakonshme, shkruan Deutsche Welle.

CORONAVIRUSI, ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË SHPALL EMERGJENCËN GLOBALE

Organizata Botërore e Shëndetë-

sisë e shpalli coronavirusin e ri emergjencë shëndetësore globale teksa numri i të prekurve nga kjo sëmundje u rrit frikshëm në 7834, shumica dërrmuese e tyre në Kinë, ndërsa 172 persona deklarohen të vdekur.

Në një konferencë të jashtëzakonshme për mediat, drejtori i përgjithshëm i OBSH, Tedros Adhanom vlerësoi autoritetet kineze për reagimin e tyre të shpejtë ndaj shpërthimit të epidemisë, duke theksuar se sëmundja do të ishte përhapur shumë më shpejt dhe gjerësisht nëse nuk do të ishte vënë nën kontroll në kohën e duhur.

“Do të kishim pasur shumë më tepër raste jashtë Kinës deri tani - dhe ndoshta vdekje - nëse nuk do të ishin për përpjekjet e qeverive”, - tha ai.

“Në shumë mënyra Kina po vendos një standard të ri për përgjigjen ndaj shpërthimit të një pandemie - kjo nuk është një ekzagjerim”, shtoi z. Adhanom.

Virusi i ri që tani quhet “2019-nCoV”, është përhapur fillimisht në Wuhan. Ka dyshime se përhapja e coronavirusit ka nisur nga higjiena e munguar në marketet ku shiten kafshë të gjalla si dhe në dyqane ku tregtohet peshk.

Sipas autoriteteve kineze nga 31 dhjetori deri më 22 janar, janë shfaqur të paktën 600 raste me coronavirus, ku 100 prej tyre janë dërguar për trajtim në spital. Sipas disa shkencëtarëve, origjina e virusit është nga gjarpri.

Bëhet fjalë për dy gjarpërinj që janë të zakonshëm në pjesën juglindore të

Kinës aty ku u përhap virusi. Por, një studim i tillë është kritikuar nga ekspertët duke thënë se nuk është e qartë nëse coronaviruset prekin gjarpërinjtë.

KËSHILLAT E OBSH-SË

Më herët, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka publikuar një listë me rekomandime të thjeshta, të cilat sipas saj, pakësojnë ekspozimin dhe transmetimin e coronavirusit të përhapur në Kinë. Në rekomandimin e saj OBSH-ja sugjeron këto masa paraprake:

- 1) Evitoni kontaktin me këdo që shfaq simptoma të sëmundjeve respiratore
- 2) Gatuani mirë ushqimin përpara se ta konsumoni
- 3) Lani shpesh herë duart
- 4) Mbuloni gojën dhe hundën kur kolliteni ose kur teshtini
- 5) Përdorni maska kirurgjike

Dogana e Bllatës, asnjë masë për coronavirusin



Masat e marra për coronavirusin siduket nuk kanë përfshirë gjithë sistemin doganor të vendit tonë. Vetëm në pikat e mëdha hyrëse është vendosur personel shëndetësor për të kontrolluar të gjithë ata që hyjnë në vendin tonë. Në doganën e Bllatës në Dibër, vetëm policët doganor mbajnë maska mbrojtëse ndaj virusit të rrezikshëm, ndërsa mungon personeli shëndetësor për të kontrolluar ata që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet kësaj pike doganore. Edhe vetë ata që përdorin këtë pikë doganore për të hyrë në Shqipëri e pranojnë se nuk janë kontrolluar dhe se nuk kanë parë personel shëndetësor aty. Kjo pikë doganore përdoret nga fqinjët e Maqedonisë së Veriut, por edhe nga Bullgaria e një pjesë e Greqisë për të hyrë në vendin tonë.



Musa Lala, ikja pa kthim e një ikone

NGA DEFRIM METHASANI

Një e nga një duket se ish-ët e dikurshëm të futbollit dibran po ikin dhe se historia nis të zbehet nga dëshmitarët e gjallë të saj.

Pas Shemsi Manjanit, nga të fundit është edhe Musa Lala, ish futbollisti i Korabit që në moshën 80 vjeçare iku nga kjo botë, duke lënë pas emrin e mirë të fiksuar në një histori që kurrë s'do të venitet, veçmas ajo kohë e artë, kur skuadra e Korabit në futboll doli për herë të parë në kategorinë e parë, pra bëhet fjalë në vitet 1962-1963.

Por, cili ishte Musa Lala dhe çfarë kontributi la pas ky mjeshtër i sportit, që jo vetëm si ish-futbollist, por mbi të gjitha si njeri dhe familjarë e veprimtarë, fitoi respektin dhe admirimin e njerëzve, ndaj kujtohet edhe sot në mungesën e tij nga kjo jetë.

Musai u lind më 8 prill 1939 në Zerqan të Dibrës, një fshat ky me shumë intelektualë dhe histori. Aty ai mbaroi me sukses shkollën fillore dhe që asokohe shquhej si nxënës i përgatitur dhe i aftë për të vazhduar më lart. Studimet i vazhdoi në shkollën e mesme ekonomike në Tiranë dhe menjëherë post mbarimit të studimeve ai nis punën si ekonomist në ndërmarrjen e Nish Prodhitëve. Por futbollit, krahas shkollës, duket se ishte një pasion i dytë tepër i lakmuar i tij.

Musa Lala e dashuroi topin e rrumbullakët që kur ishte në shkollë në Zerqan, por që njohu ngjijtje cilësore kur vajti në Tiranë në shkollën e mesme. Mësuesit e fizikulturës e shihnin gjithnjë si një futbollist që mund të luante me skuadra profesioniste. Gjithsesi, ai vendosi të rikthehej në Peshkopi dhe aty të niste edhe karrierën futbollistike. Starti i tij është në vitin 1959 me ekipin e të rinjve të Korabit, por



falë aftësive lëvizore dhe intuitive, ai do të kalonte shpejt tek të rriturit e Korabit. Shërbimi ushtarak e ndërpreu marrëdhënien e re që sapo kish nisur me Korabin dhe shkon në Krujë, ku edhe kryente shërbimin

ushtarak dhe nisi të luante futboll. Për një vit ai ishte lojtar i skuadrës krutane, ndërsa më pas rikthehet sërish tek Korabi, pikërisht atëherë kur Dibra kishte nevojë më shumë se kurrë, sepse skuadra u ngjit për herë të parë në histori, në kategorinë e parë, krahas emrave të mëdhenj si Partizani, Tirana, Dinamo, etj.

Kontributi i tij tashmë u konsolidua dhe lojtari me nr. 6 shquhej si figurë sportive popullore duke fituar edhe simpatinë e një publiku të gjerë. Karriera e tij me Korabin zgjati deri në vitin 1972, sepse të tjerë dibra erdhën në skenën e futbollit dibran. Por për një dekadë që ai luajti me Korabin, dy ishin tiparet dalluese të tij. Së pari lufta e fortë sportive dhe së dyti shpirti që tregonte në lojë.

Musa Lala ishte një sportist karizmatik që bënte diferencën me vetmohimin e tij. Ai i shërbente skuadrës me energjitë pozitive që e karakterizonin. Sa herë bëheshin përvjetorë apo kumtesa e festa sportive, kujtohej emri dhe kontributi i tij, si një protagonist i atij brezi të artë që Dibra nxori në ato vite.

Në një bisedë me mjeshttrin e sportit, ish trajnerin dhe specialistin e mirënjohur Bexhet Shehu, mësojmë faktin se Musai kish fituar admirimin e tij dhe tifozëve të futbollit, sepse ai ishte një mbrojtës luftarak dhe se përpiquej që në lojë të jepte maksimumin e tij.

Kështu mendon edhe njëri nga bashkëkohësit e tij, Shuaip Methasani. "Shkoja e shihja ndeshjet e Korabit në stadium. Musai ishte në krah të Taxhit dhe që të dy bëheshin barrikadë për kundërshtarit. Sa merrte topin Musai, njerëzit brohorisnin sepse futej fort për topin e parë dhe frenonte aksionet e rrezikshme të kundërshtarit".

Pas lënies së futbollit, Musa Lala vijoi të punonte në detyra të ndryshme si revizor dhe ekonomist, qofshin këto në komitetin ekzekutiv, apo në ndërmarrjen pyjore dhe në kontrollin e shfrytëzimit të automjeteve. E gjithë jeta e tij, ishte e lidhur me njerëzit dhe korrektesa ishte tipari dallues për të.

Këshilli i Qarkut të Dibrës, në kuadrin e 75-vjetorit të krijimit të Klubit Sportiv "Korabi" e ka nderuar me titullin "Nderi i Futbollit Dibran", me motivacionin "për kontribut në zhvillimin masiv dhe përparimin cilësor të futbollit në Dibër".

Tani që ai nuk jeton, padyshim vlerë marrin kujtimet në adresë të Musait, kujtime që do të jetojnë gjatë dhe do të promovohen shpesh, duke e bërë atë një figurë të paharruar dhe mjaft popullore, jo vetëm në Peshkopi, por edhe në Tiranë, ku pas viteve 1990, si shumë të tjerë, zgjodhi të jetonte në metropol.

Komuniteti dibran ishte i shumtë në pjesëmarrje edhe në ditën e lamtumirës së tij, duke ndarë dhimbjen me familjen Lala dhe të afërmit e tyre.



VLERËSIME PËR MUSA LALËN

NJAZI SHEHU, ISH FUTBOLLIST:

Musa Lala në pozicionin e tij si mesfushor shkatërrues ishte përherë një garanci në mesin e fushës së atij ekipi të madh të asaj periudhe. Dallohej për intelektin e tij si dhe forcën shkatërruese të kundërshtarit, duke qenë një nga protagonistët e rezultateve pozitive të asaj periudhe. Nuk mund të lë pa përmendur që ai ishte shumë komunikues dhe ndihmonte me këshillat e tij edhe ne, që atëherë ishim më të rinj si unë, Mufit Shehu e të ndjerët Mustafa Melani, Njazi Qorrollari (Sadiku), e portierët Bashkim Lala e Fadil Shulku. Në këtë periudhe ekipi ishte me përbërje gjeneratash të kombinuara, të vjetër e të rinj nga trajneri i mirënjohur Bexhet Shehu, ku luanin edhe të ndjerët Taxhedin Shehu e Islam Rama, si dhe mësuesi im Lutfi Manjani, Atli Shehu e kolegët si Remzi e Naxhi Lazimi. Pa e ekzagjeruar, ky ekip ishte shumë i respektuar dhe ndoshta nga më të vlerësuarit e asaj periudhe si nga publiku ashtu edhe nga kundërshtarët.

Largimi i tij, përveç boshllëkut që lën në familjen e tij, na prek dhe na hidhëron të gjithëve ne, që e njohëm dhe kaluam kujtime të paharruar nga ato vite.

FEHMI LLESHI - BASHKËQYTETAR:

Ndarja nga jeta e ish futbollistit të Korabit të viteve 1960-1972 më preku shumë dhe më ngjalli kujtime, sepse kam pasur rastin që ta shoh në fushë kur luante si lojtar me nr. 6.

Ishte një lojtar i fortë dhe jepte më të mirën për ekipin, ku dallohej në mesin e fushës si shkatërrues, duke ndihmuar shumë në mbrojtje. Ishte model, me disiplinë dhe korrekt gjatë lojës, duke zbatuar me rigorozitet udhëzimet e trajnerit.

Unë e njihja mirë familjarisht dhe ruaj kujtimet shumë të mirë për Musain si njeri i dashur me shokët dhe miqtë e tij. Ai krijoi një familje të mrekullueshme, bashkë me bashkëshorten Drita, e cila edukoi breza të tërë si mësuese dhe fëmijët Fatbardhin, Adrianin dhe Elsën, duke dhënë kontributin e tyre në shoqëri, nën shembullin e babait të tyre, Musa Lala.

Me rastin e 7 marsit festës së mësuesit dhe 8 marsit festës së gruas

festat

Një gjyshe e lumtur

NGA ZABIT LLESHI

Në një nga emisionet televizive të TVSH-së u diskutua për gjyshërit dhe gjyshet, për rolin e tyre në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Kjo i bënte ato të lumtur, u jepte shpresë dhe u zgjaste jetën duke u mbushur një pjesë të mirë të kohës së tyre të lirë gjatë moshës së tretë.

Përjetova emocione, kujtimet më çuan larg në fillimet e jetës sime si edukator në vitet 70. Ndërmend më erdhën shumë kolege, edukatore që nga Bulqiza, Peshkopi e deri në Baldushk të Tiranës ndërmet tyre: Eleni Kola, Shirete Sharku, Fiqirete Strazimiri, Yllka Spahiu, Liljana Dapi etj.

Njëzet vjet të punës në Tiranë ishin dhe mbetën një përvojë interesante e jetës sime në arsim. Midis tyre tre vjet në Baldushk gjeta një ambient të përshtatshëm për punë, mora me vehte respektin e pritjen e atyre njerëzve të çiltër, puntor, bujar e mikpritës. E ndiej për obligim të shkruaj për ato kolegë të dashur e miqësor me të cilët i ruajmë konsideratat pas kaq vitesh tashmë në pension.

Baldushku ka një traditë të shkëlqyer në fushën e arsimit dhe kulturës. Të shumtë janë mësuesit vendas dhe të ardhur që kanë dhënë ndihmesën e tyre në shkollat e kësaj treve arsimdashëse që nga Vishnja në Vrap. Kësaj radhe dëshiroj të ndalem në njërin prej tyre dhe konkretisht për Liljana Dapin:

Liljana punoi si mësuese në ciklin e ulët, në pjesën dërmuese të punës në arsim ajo dha mësim në kopësht. Është e njohur tashmë që edukimi i fëmijëve fillon në kopësht, aty merren elementet e para të edukatës shkollore prandaj edukatorja nuk harrohet nga fëmijët, prindërit dhe nga mbarë shoqëria.

Liljana Puriqi lindi më 16 janar 1956, në një familje qytetare të vjetër të Beratit. Babai i saj Stavri me punën e tij të ndershme në ndërmarjen e transportit të autobusëve rriti nëntë fëmijë, tetë vajza dhe një djalë. Pas shkollës tetëvjeçare "Çlirimi" në Berat Liljana ashtu si motrat e saj bëri përpjekje për të filluar punë për të ndihmuar sado pak familjen, por ajo ishte në periudha të shkurtëra dhe pa ndonjë perspektivë.

Në vitin 1974 ajo u njoh me Rrahman Dapin nga Baldushku me shërbim ushtarak në Bera, pas dy vjetësh njohje vendosën të martoheshin pa dëshirën e prindërve. Në familje gjeti rezistencë që ndeshesh shpesh në ato vit. U deshën durim e këmbëngulje që sollën mirëkuptimin e dy familjeve. Si të gjithë prindërit edhe ata mendonin se vajza është larg, disa gojë të liga nxirrnin pengesë fenë. Liljana e krishterë e Rrahmani musliman.



Lili, kështu e thërrasin nusen e re erdhi në një familje patriotike e arsimdashëse në Tiranë. Vjehrrin e saj Muharremi, veteran i luftës nacional-çlirimtare, përkrahës i së resë përparimtare, arsimdashës kërkoi dhe arriti të pajtoi familjen me ato të miqësisë së re, ndërsa Lilin ta dërgoi në shkollë për mësuese në pedagogjiken e Tiranës së bashku me vajzën (kumatën) Nurijen.

Strehimin për mësueset e ardhshme e mori përsipër gjyshja nga nëna e Rrahmanit, Kumrie Dorëzi, bashkëshortja e Halil Dorëzit dëshmor i luftës Nacional-Çlirimtare nga Peza.

Me mbarimin e shkollës së mesme u emërua mësuese në ciklin e ulët në Baldushk ku punoi 37 vjet. Në punën e re ajo u ambientua shpejt, u njoh me kolektivin dhe detyrat e reja që shtroheshin për shkollën në ato vite. Dalngadalë krijoi përvojën dhe eksperiencën e saj për edukimin e brezave. Ajo kish marrë me vehte kulturën qytetare të Beratit prandaj dhe u shqua për marrëdhënjet me fëmijët e prindërit si dhe kolegët. Gjithnjë u dallua për disiplinë, rregull, pastërti gjë që u reflektuar në rezultatet e saj si mësuese dhe edukatore. Për një periudhë të shkurtër, Liljana do të njihet nga drejtuesit e shkollës "Feti Vogli" dhe ato të institucioneve të rrethit të Tiranës ndër mësuesit që përvojën e mirë e

traditat e shkollës së Baldushkut do t'i çonte më përpara në fushën e edukimit të brezit të ri.

Çdo njeri përpiqet të lërë gjurmë në punën e tij, pastaj varet se sa këto gjurmë lënë mbresa që ruhen për shumë vite. Kujdesi i Lilit për të lënë mbrapa kujtime që zor se shuhen nga ndërgjegja e shumë të rinjëve dhe të rejave ishte për t'u admiruar. Siç na thotë edhe ish drejtori i shkollës Gjet Buna, Liljana shprehte inetrës e kujdes të veçantë për mirëedukimin e fëmijëve, për pastërtinë, higjienën, rregullin, elementet e para të edukatës, ajo mbante lidhje të rregullta dhe bënte një punë të lavdërueshme me prindërit.

Me nënat e reja, mernte informacion shqetësimit e përditshme të tyre, për shëndetin, ushqimin e deri tek problemet e ngrohjes, sigurimin e bazës materiale e konkretizmin e orës së mësimi.

Mësuesit e Baldushkut dalloheshin për një punë sistematike, unitet e ndihmë të kualifikuar e reciproke për njeri tjetrin. Suksesi varej nga puna zinxhir e vazhdueshme nga kopshti në klasat e para. Rezultatet e mira të kolegëve Ferik Sula, Hysni Ferati, Nurie Rama, Rina Vrapi, Fatmir Vrapi, Muharrem Ahmeti etj, ishin domosdoshmërisht edhe një pjesë e mirë e punës së Liljanës në arsimin para shkollor. Pa dyshim puna

dhe merita e këtyre mësuesve, thotë Bashkim Miftari, që shkolla e Baldushkut radhitej ndër shkollat më të mira të Tiranës. Shkolla jonë është vlerësuar vazhdimisht nga kontrollet e Ministrisë Arsimi dhe Drejtorisë Arsimore të rrethit.

Eksperiencia e mirë e kopshtit të Baldushkut është njohur nëpërmjet seminareve, orëve kualifikuese e model që janë organizuar me pjesëmarrjen e gjithë edukatoreve të kopshteve të zonës Baldushkut e më gjerë. Sigurimi i mjeteve të pregaditura nga vetë mësuesja, konkretizimi i mësimi, këmbëngulja për përvetësimin e njohurive aq sa kërkohen për moshën, lidhja e bashkëpunimi me prindërit ka qenë çelsi i suksesëve në punë të edukatores Liljana Dapit, na tha Ferik Sula mësues i vjetër në Baldushk.

Në vitin 2013-2017 punoi si edukatore kopshti në Koçaj duke e kthyer në model të kopshteve në njësinë administrative të Baldushkut. Atje solli përvojën shumë vjeçare të saj tashmë në një ndërtesë të re që e paasi me mjete bashkëkohore të pregaditura vetë që u shoqërua me mjaft rezultate pozitive në klasën e parë të asaj shkolle. Liljana Dapi ndërtoi marrëdhënje të mira korrekte me drejtuesit që nga Lesko Gjata, Përparim Pirushi, Vladimir Shaka, Bashkim Miftari, Gjet Buna, Mehmet Hasani, Veli Plaku, Lumtor Ibraliu, Osman Harizi e deri tek më i riu Renald Dapi në Koçaj ish nxënësi i saj etj.

Liljana Dapi me kolegët e saj pati rastin të edukoj një brez që i dha shumë kuadro që ndihmuan për përparimin shoqëror e kulturor të trevës së Baldushkut. Ata shërbejnë me devotshmëri në fushën e arsimit ku ndërmet tyre përmendim: Renald Dapi, Bledar Vrapi, Brunilda Rama, Gentian Tafa si mësues, Jonida Bali si ekonomiste e shumë të tjerë në fushën e biznesit e sektorë të tjerë të ekonomisë.

Mësuesit e Baldushkut kanë dhënë një ndihmesë të çmuar në fushën e kulturës e gjallërimit të verpimtarive sportive. Ato mbajtën gjallë dhe çuan më përpara traditat në këto fusha të rëndësishme të edukimit, emancipimit shoqëror e përparimit të ekonomisë në rrethin e Tiranës.

Bashkëshorti i Liljanës, Rrahmani punoi si hidraulik në ujësjellsin e fshatit. Pas ardhjes familjarisht në Tiranë, në vitin 200 u sistemua në profesionin e tij në Ndërmarrjen e trajtimit studentëve. Liljana krijoi familjen me Rrahmanin i cili sot është në pension. të dy së bashku kanë tre fëmijë: Dhuratën, Nardin dhe Romeon. Ata mbaruan shkollën e mesme në Baldushk. Ishin një shembull për shkollën në sjellje e në marrëdhënje me shokët e më-

suesit.

Dhurata një nxënëse ekselente për 11 vite ishte krenaria e shkollës. Sipas shembullit të prindërve ajo me dashuri u martua me Artan Lulën. për disa vite punuan në Greqi (1997-2010). Kanë tre fëmijë: Nikolla student në universitet, Kristina në gjimnaz, Iljana në nëtëvjeçare. Ashtu si Dhurata edhe ato janë ekselente në shkollë e jashtë saj. Familjarisht punojnë në një biznes privat në Sauk. Nardi, djali i madh, mjeshtër druri, ka dy djem; Renald dhe Albioni.

Romeo është martuar me Rajmonda Shadikun matematicine, të dy punojnë në firma private, kanë një vajzë që quhet Vivja.

Liljana është në pension por nuk është larguar nga profesioni, ajo mban dhe kujdeset për edukimin e Vivjas si edukatore në rolin e gjyshes. Bashkë me Rrahmanin u gëzohen nipërve dhe mbesave ku gjejnë lumturinë duke marrë edhe dashurinë, frymëzimin e krenarinë etj.

Si të gjithë gjyshërit në Tiranë ato i bëjnë një shërbim të madhe shoqërisë duke edukuar e kujdesur për mirërritjen e fëmijëve, duke zëvendësuar kështu shpesh herë e prindërit e rinj por edhe mësuesit. Shoqërojnë e përcjellin fëmijët në kopësht, shkollë, veprimtari kulturore edukative në mësimet jashtë klase e shkolle, kurse etj. Kursejnë kohën e punës për nënat e baballarët e tyre. Këto të fundit janë shumë mirënjohës për atë çka bëjnë e shërbimet që u afrojnë të vegjëljve gjyshërit.

Si shumë qytetarë të tjerë, na thotë Rajmonda: "fatmirësisht i kemi afër" Lili, shfrytëzoi natyrën e qetë të kodrave të liqenit që fatmirësisht kemi afër, ambientin e kulturuar të pastër për shëtitjen me fëmijët. Ajo na ka lehtësuar shumë, shkojmë me mendje të fjetur në punë se vajza jonë do të ushqehet, pushojë e argëtohet më së miri gjatë kohës që është me gjyshen e saj.

Vetë gjyshërit gëzohen e lumturohen kur ato mësojnë mirë në shkollë, rriten të shëndetshëm, stërviten në ekipet sportive, marrin pjesë në veprimtari artistike e bëjnë një jetë të pasur e aktive.

Sa më mirë ti bëjmë këto aq më mirë e më me dinjitet garantohet vazhdimësia e brezve, aq më mirë e më e shëndoshë do të jetë shoqëria e familja. Kjo është detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme që duhet të realizojnë gjyshërit nga brezi në brez.

Jemi përpara dy festave, 7 marsit festës së mësuesit dhe 8 marsit festës së gruas. Si nënë, gjyshe e mësuese i urojmë Liljana Dapit festa të gëzuara, ditë të lumtura, jetë të gjatë e mbarësi në familje.

in memoriam

Dedikim babait tim, dhe kujtimit të nënës sime, me rastin e 72 vjetorit të qytetit të Bulqizës

Letër babait

NGA DHURATA KOLA KALOSHI

I dashur baba,

tani që po të shkruaj, ti ndoshta je ulur në kafenenë tënde të preferuar, për të shijuar kafën e mëngjesit, ndërkoh që duke dredhur cigaren e rradhës, në heshtje dëgjon bisedat e miqve që të rrethojnë.

Ke qenë gjithnjë fjalëpak. Tani akoma më i heshtur je.

Pesha e jetës sikur t'i ka rrëmbyer fjalët, për ti lënë vend heshtjes mendimtare, së cilës paqësisht i je lëshuar në prehër.

Herë, herë, ndërsa përhumbesh ndër kujtime, sytë të njomen, ndërsa frymëmarrja të bëhet më e thellë, pastaj ngre vështrimin duke e lënë të tretet diku larg si në kërkim të diçkaje që të mungon ..

Ditët e fundit e kam kapur shpesh veten në të njëjtin përjetim. Ndoshta për këtë është fajtoresha stina.

Këtu ditët e Dimrit, ndonëse jo aq të ftohta, me se shumti janë të mugëta, sidomos mëngjeset. Edhe tani që po të shkruaj, dita ka ardhur e mugët.

Ca pika të rralla shiu herë pas here shëmben mbi xhamin e dritares e rrëshqasin në faqen e lëmuar të saj deri në tretje, duke lënë pas vetëm vragat e rrugëtimit të tyre mbi qelq.

Ndonjë pikëz arrin tia dalë e ta përfundojë udhëtimin e saj deri në fund, porse ca të tjera, tretën ende pa mundur te bëjnë gjysmën e rrugëtimit të tyre ..

Ndërsa i vështroj në përpjekjet e tyre të mbijetesës, më krijohet një ndjenjë e trishtë përzier me një ndjesi malli ..

Do të doja të isha pranë teje, që ta pinim kafënë e mëngjesit bashkë, duke biseduar si dy miq të mirë. Më pëlqen të dëgjoj rrëfimet e tua, ku zën vend historit të veçanta të mbushura shpesh me përjetime të vështira.



Më kujtohet gjithnjë koha kur të kam njohur burrë të ri në moshë. Ecja jote karakteristike, me kokën lart dhe gjithnjë me vështrimin drejt, dhe kjo jo e thënë figurativisht.

Gjithnjë me pamjen e njeriut, që nuk trembej ta vinte në dukje krenarinë dhe "rrebelizmin" e tij. Me pëlqente që ishe i tillë.

Fakti që rrezatoje një burrë të fortë, më bënte krenare. Vetëm sytë e tradhëtonin herë pas here, "egërsinë" tënde, duke zbuluar butësinë e një njeriu të dhëmbshur deri në "përlulesi".

Cuditërisht, sa herë kthej kokën pas, kujtimet e fëmijërisë sikur më kan zën peng. Është e pamundur të kapërcej ndër copëza të tjera kujtuese, pa kaluar në rrugicat e kësaj pjese të jetës sime. Imazhi i shumë casteve e momenteve të kësaj periudhe të jetës, më shfaqet kaq i qartë para syve, gati në ripërjetim.

Shtëpiza e vogël, ku jetonim pes familje, ime më që me gatimet e saj jepte një aromë të këndshme të gjithë hapsirës së koridorit të përbashkët të asaj banese, sidomos për ditëfestat, që nuk kalonin pa miqtë tuaj.

Unë i përjetoja me një ndjesi të veçantë ditët dhe netët, kur shtëpia jonë gumëzhinte nga të ftuarit. Ndërsa struktesha tek një qoshek, ndiqja me ëndje lëvizjet plot hire të së ndërës nënës tonë, ndërsa u shërbente mysafirëve gatimet e saj të mrekullueshme.

E di? - Nëse tani do të ndalesha të shkruaja për gjith ato vite kur ti dhe e jona më, nuk ishit vetëm bashkëshort e prindër por edhe dy koleg të mirë, ndoshta nuk do të ndalesha për ditë e ditë të tana, duke treguar e përshkruar atë përkushtim tuajin jo vetëm për ne, por edhe për punën, për atë që ishit, për atë që ju sollët në atë qytet, rreth e krahinë, si të parët gastronom modern te specializuar nga profesor të shquar rus e çek, në shkallën më të lartë të fushës suaj.

Nëna jonë e ndjera, pak kush e di se që e para grua jo vetëm drejtuese në atë qytet, por që hartoi e vendosi normat e ushqimit për fëmijët e çerdhës dhe të kopshtit, e rregulla të tjera për kontrollin e mbarëvajtjes të shëndetit të tyre.

Ndërsa ti, si një anëtar i grupit të punës që studioj, hartoi e vendosi të gjitha normat e qindra recepteve ku do të bazohej i gjithë zhvillimi i gastronomisë shqiptare për kohën.

Atë kohë, qyteti ishte ende vetëm një qendër e vogël pune e banimi për specialistët e punëtorët e minierës, zhvillimi i së cilës varej nga miniera. Ju ishit ndër të parët banor të tij. Më parë t'i vet kishe qenë një nga punëtorët e parë të minierës.

Kushedi sa ëndërra thurët për të ardhmen profesionale tuajën. Por në atë qendër banimi, fjala dhe as koncepti i gastronomisë moderne ende nuk egzistonte.

Ideja e të trajtuarit të kësaj fushe jo vetëm si art, por edhe si shkencë, natyrisht ishte ende surreale. Ndërkoh që në botën e zhvilluar prej shekujsh qarkullonin botime, jo vetëm me përmbledhje recetash por edhe me njohuri mbi efektet e mënyrës së të ushqyerit



në shëndetin e njerëzve, ju do të ishit të detyruar ti nënshtroheshit mungesës së theksuar të materialit e të aparatës profesionale, duke e cunguar realisht hapsirën e zhvillimit të artit tuaj.

E megjithatë ju ja dilnit gjithmonë që të përmbushnit edhe në praktik ambicien për ti ofruar njerëzve një meny të pasur edhe pse ato vite shumica e një sër emrash të asortimenteve në listën e gjatë të menys, ishin për shumicën e klientelës të panjohura me parë, ndaj ju u perpoqët që me fines te mos shkëputeshit krejtësisht nga tradita.

Në të gjith ato vite bashkëpunim, ju i dhatë jo vetëm qytetit por mbarë krahinës për të parën herë një emër në fushën e gastronomisë, duke e kthyer restorantin e vetëm të qytetit për 15 vite rresht, në një nga restorantet me të njohura për cilësinë dhe shijen e asortimenteve që serviroshin.

Nuk kishte se si të ndodhte ndryshe, me dy njohës shumë të mirë jo vetëm të kuzhinës shqiptare por edhe asaj ruse, çeke, mesdhetare, etj.

Per fat të keq, edhe sot, kjo fushë e zhvillimit të qytetit e krahinës, nuk trajtohet aspak seriozisht, duke u konsideruar për shkak te mungesës se kulturës në këtë fushë, si një fushë krejt e parëndësishme për historikun e një krahine apo qyteti, ndërkoh që qytete të njohura në botë prej shekujsh identifikohen me zhvillimin e kulturës së gastronomisë, dhe kulinaris, si p.sh; qyteti Monteon në Franc me restorantin „Mirazur“ numri një në botë, apo Copenhagen me „Noma“, numri dy në botë, apo qyteti Axpe me restorant „Asador Etxebarri“ (Spanj), numri tre në botë, Bankok (Tailand) me restorant „Gagan“ , numri katër në botë për 2019, etj etj.

Unë e di që gjatë ushtrimit të profesionit sidomos pas viteve 90, ke marrë komplimente nga koleg të vëndeve të huaja fqinje apo më gjër, por ky ishte vetëm një ngushëllim i vogël për atë çka ju kishit humbur në disa dekada. Madje as hapsira që Tv e Himarës të krijoj për të patur programin tënd, sigurisht nuk do t'i përmbushte krejtësisht ëndërrat e humbura ndër ato dekada te vështira për të gjithë shqiptarët.

Në jetën time jeni të parët ndër të paktët njerëz me integritet, që kam njohur. Sepse kjo cilësi, ndërkoh nuk është vetëm kaq, por është edhe një peshë e rëndë që jo kurrizi i gjithkujt mund ta përballoje, pasi që sa më integër të jesh, aq më e rëndë është sfida.

E kjo do të thotë të jesh, përjetësisht në betejë, sepse jeta nuk kursen askënd.

Ajo shpesh na vendos përball sfidash, për të cilat nuk do të kishim zgjedhur kurrë.

Loja me sfidat përball të cilave jeta na vendos, shpesh herë më duket një sprovë, përmes së cilës kërkohet një përgjigje, nëse është jeta vet dilema, apo jemi ne vet njerëzit, dilema e jetës.

Porse sfidat, dhe provat e jetës nuk e lëkundën asnjeher atë besim të brendëshëm që ju karakterizonte. Nuk e lëkundën të qenit besnik ndaj vetvetes dhe bindjeve tuaja, ndonëse ju desh ta ndërtonit jetën tuaj në kohra të vështira, e ndoshta në këte kuptim, ju nuk mund të ishit dilema e jetës përveçse luftetar te papërunjur të kësaj fushbeteje.

Sot, jeta sërish të ka vënë përball një sfide të madhe, e ti me po aq "rrebelizem" po vazhdon ta sfidosh vet sfidën

Në sytë e mij je po aq i fuqishëm, e kjo më ngjall ndjesinë e të qenit po aq femij si dikur, me nevojën që dora ime të humbet në pëllëmbën e dorës tënde të madhe.

Më ndodh ndonjëherë, të pyes veten se, cilët do të kishim qen, nëse do të ishim rritur ndryshe, a në një qytet a vend tjetër.

Nuk e di. Natyrisht, nuk mund t'i jap përgjigje kësaj pyetje, por ajo që di të them me siguri është se, me besë, nuk do të doja të isha ndryshe, pasi nuk mund ta imagjinoj dot veten, se çmund të isha nëse do të isha rritur në rrethana të tjera. Nuk më pëlqen kur mendoj se mund të mos isha kjo që jam

A është kjo ndjenjë, ndjenja e të paturit respekt për veten? A fillon e gjitha këtu?

Nëse është pikërisht kjo, atehere ju prindërit e mij, jeni të vetmit njerëz për te cilën mund tju "fajsoj", sepse ishit ju që na kultivuat njerëzoren, e të mbelemi të tillë, kudo ku do të na hidhte jeta.

Ju na mësuat se në trenin e jetës tënde, lipset të jesh vet mashinisti, dhe jo pasagjeri që pret radhën t'i tregojë biletën konduktorit ..

Ndaj sot jo rastësisht, nuk je i vetëm në këtë sprovë të madhe përball së cilës të ka vënë sërish jeta.

Rreth teje janë fëmijët e tu, mbesat, nipërit, stërnipërit e njerëzit e mirë të atij qyteti, të cilët në shenjë rrepekti të thërrasin Gjyshti

A ka "dekorat" më të bukur se kjo ?

Shtëpia, vazhdon të jetë plot jetë, mbushur me zëra gazmor të filizave të rinj. Ajo vazhdon të gumëzhij në ditëfestat e të mbajë gjallë kujtimin e njerëzve tanë më të dashur që nuk i kemi më mes nesh. Dera vazhdon të jetë e hapur, e prej saj vazhdon si gjithnjë të përhapet po ajo ngrohtësi, që përcjell paq e dashuri ndër ne. Nuk do ta këmbëja atë dashuri, me asgjë tjetër.

Dashurinë e shtëpisë së prindërve. Uroj të të kemi mes nesh edhe për shumë vite, at i dashur, sepse kemi nevojë për ty.








**Me dashurinë e bijës,
Dhurata**

“Rizgime meteorësh”, “DiBRA”, “Fisi Cami i Dibrës”, “Emblema Ime”, “Refleksione estetike”, “Ura e fjalës”, “Vargonjtë e fatit”, “Shëmbëlltyra në folklor dhe letërsi”, “Zjarret e ditëve”, ...

mozaik

B O T I M E

TË AUTORËVE NGA BULQIZA



RETE PAS

Shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballeshme

Një program i rezervuar dhe personalizuar për qytetarët shqiptarë për të hyrë në shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballeshme.



FIRENZE RETE PAS, GARANTON: Shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese; Një rrjet ambulatori iali përbërë nga 11 qendra në territorin e Firences dhe me një mesatare prej 20,000 hyrje në muaj.

Shërbim i shpejtë pa kohëpritje.

Komunikimi mundsohet nga përkthyes të specializuar në këtë fushë

NDËR SPECIALITETET QË NE OFROJMË JANË

- Alergologjia, Angiologji, Kardiologji, Kirurgji, Dietologji, Dermatologji, Ecografi, Endokrinologji, Gastroenterologji, Gjinekologji, Gjeriatri, Neurologji, Nefrologji, Okulistika, Ortopedia, Osteopatia, Otorinolaringologji, Pediatria, Pneumologji, Psikiatri

RETE PAS ofron shërbime shëndetësore me tarifa të përballeshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta, veçanërisht në fushën e diagnostikimit:

- radiologji,
- resonance magnetike, tac – Mamografi dhe tomosintezë, - ekografi ... me përdorimin e pajisjeve të avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike, në tredimensione (siç është për tomosintezën e gjirit).

ORGANIZOJME GJITHÇKA në kohën që ju ose i afermi juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizite e pacientit me përkthyes shqipëtar.

Per informacione dhe prenotime na \kontaktoni: Email: age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580
WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)

Organizojmë gjithçka në kohën që ju ose i afermi juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizite e pacientit me përkthyes shqiptar.

Për informacione dhe prenotime na kontaktoni: Email age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580 WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)